ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 21 GUSHT 2021. NUMËR 144 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Botohet në anglisht "Shqiptarët në art" i studiuesit Ferid Hudhri

"ALBANIANS in ART"

është libri i parë që duhet të vendoset në tavolinën e zyrës së çdo diplomati të huaj në Shqipëri. Ky është libri i parë që duhet të zbukurojë sallonin e çdo shqiptari që banon jashtë atdheut – e variantin anglisht, jo shqip, që të kuptojnë të gjithë mysafirët ..."

Nga David Hosaflook PhD

(fq. 2-4)



MISTERI SE SI U DËRGOVA NË PRAGË PËR OPERATOR FILMI

Nga Piro Milkani (fq.10)

Për mua, atë vit ngjarjet më të rëndësishme ishin letrat shumëfaqëshe që Viktor Gjika, shoku im i fëmijërisë, më dërgonte nga Moska. Më tregonte në to jetën e magjishme që po kalonte në Institutin e Lartë të Kinematografisë –VGIK- ku po studionte fillimisht për regjisor të filmave dokumentarë shkencorë....

SHËNIME PËR LIBRAT

Romani "Kështjella" i Kadaresë

STRUKTURA NARRATIVE DYLINJËSHE NË NJË METAFORË QËNDRESE

(fq.8)

variant i shkurtuar nga studimi

Nga Shazim Mehmeti

PREÇ ZOGAJ-"IN LOVE", NJË MELODI POLIFONIKE

Nga Ali Aliu (fq. 9)

Libri "In Love" i autorit Preç Zogaj është një libër poetik i veçantë për disa arsye. Ky vëllim sjell njëqind poezi të lidhura pas një boshti tematik, ku dashuria, është qendra. Në këto poezi ka mall e ngjyrim melankolik në prag elegjiak, ka afsh dhe zjarr emocional të gjallë, ka mëtim për ta pushtuar dhe për t'u pushtuar nga dashuria...

LIBËR QË SJELL NJË PËRVOJË TË RE NË TRADITËN TONË

Nga Emin Azemi (fq.7)

Pra, ishim marrë vesh me Gani Bytyçin që të thyejmë një rutinë në traditën e shënimit të ditëlindjes së studiuesit, shkrimtarit e mikut tonë të dashur, prof. Anton Nikë Berishës...

SHQIPJA DHE HUNGARISHTJA, DY NGA GJUHËT UNIKE TË EUROPËS

Bisedë e gazetares Mimoza Hasani Pllana, me Krisztián Csaplár-Degovics, albanolog dhe historian hungarez

(fq. 5)

NË IZOLIMIN E HOTEL DAJTIT

(fq. 16)

Nga Odile Daniel

ELITIS NË SHQIP DHE DISA PROBLEME TË PËRKTHIMIT TË POEZISISË SË TIJ

(fq.22)

Nga Aristotel Spiro

(fq.22

BIBLIOTEKË

Ilir Levonja (fq. 14)
Gruaja me qerpikë gjelbër

Nerinda Hysa (fq. 13)
Prozë e shkurtër

Sami Milloshi (fq. 15)
Dy tregime

Jane Gardam (fq. 18)
Miq të përzemërt

Artur Balli (fq. 20)
Psalme për jetën (Përkthime)

PYETËSORI "LIBRAT E JETËS SIME"

ROLAND GJOZA: LIBRI QË DO TË DOJA TË KISHA SHKRUAR? "BUKUROSHET E FJETURA" TË KAVABATËS"

(fq. 12)

Botohet në anglisht libri "Shqiptarët në art" i studiuesit Ferid Hudhri

ALBANIANS in ART

është libri i parë që duhet të vendoset në tavolinën e zyrës së çdo diplomati të huaj në Shqipëri. Ky është libri i parë që duhet të zbukurojë sallonin e çdo shqiptari që banon jashtë atdheut – e variantin anglisht, jo shqip, që të kuptojnë të gjithë mysafirët ...

Nga David Hosaflook PhD

Në vitin 2012, kam përfunduar përkthimin në anglisht të librit të Marin Barletit, *Rrethimi i Shkodrës*. Disa javë pas botimit, kam pirë një kafe me mikun tim, të ndjerin Robert Elsie, te Pesëmbëdhjetëkatëshi. Ai e mori librin me kënaqësi, dhuratë prej meje dhe botuesit "Onufri". Më tha: "David, nuk jemi shumë veta që mund të përkthejmë mirë nga shqipja në anglisht. Të paralajmëroj se tash e tutje shumë njerëz do të të kërkojnë të përkthesh librat e tyre".

E kështu ndodhi. U keqkuptua sikur jam përkthyes. Nuk jam. Kam mjaft angazhime, në familje, në kishë, në punë shkencore. *Rrethimi i Shkodrës* ishte një projekt personal, një punë dëshire, si banor i Shkodrës dhe amerikan gegëfolës. Ndaj, secilit kërkues duhet t'i shpjegoja se, ndonëse përkthej mirë, nuk kam kohë për projekte të reja. Bie dakord që thesaret e letërsisë shqipe dhe të historisë shqiptare duhet të përcillen në gjuhën time amtare, në anglisht, e për këtë arsye më vjen sinqerisht keq kurdoherë që më duhet të refuzoj kërkesën e ndonjë shkrimtari, poeti a historiani të respektuar në shoqërinë shqiptare.

Ndryshe vendosa për librin e Ferid Hudhrit (nëse mund ta quajmë "libër"). Së pari, autorin e kam mik. Feridi ka qenë këshillues, motivues dhe udhëheqës shkencor për doktoraturën time. Është burrë i rrallë, e mjaft i sinqertë. Është i shquar në fushën e historisë së artit, por nuk i bien borisë për arritjet e tij. Përkundrazi, atij i parapëlqen ta lërë punën e tij të flasë vetë, dhe me gojën e tij lëvdon të tjerët. Ku ka njerëz të tillë në botë? Ku ka mjeshtër që nuk u tregojnë të gjithëve se sa mjeshtra janë, por, për më tepër, që frymëzojnë të tjerët që të rrisin standartet e tyre të punës?

Megjithatë, nuk ishte vetëm miqësia apo mjeshtëria e tij që më shtyu të pranoja këtë projekt përkthimi. (Kam refuzuar mjaft miq e mjeshtra të tjerë.) Më shtyu *libri.* E jo sepse jam i apasionuar pas artit. Nuk jam. Madje, më vjen pak turp të rrëfehem se, sikur të vihesha para një vendimi, a të dal në një ekspozitë arti apo të shkoj në një ndeshje futbolli, do zgjidhja të dytën, duke u gjendur pranë njerëzve me fara luledielli në gojë, e jo pranë atyre me gota vere në dorë. Ndoshta nuk jam aq i rafinuar.

Por kjo është mjeshtëria e veçantë e këtij "libri" të Ferid Hudhrit. Të bën për vete, pavarësisht nëse di apo jo të dallosh një akuarel prej një pikture me vaj, një vizatim nga një litografi. Është udhëtim vizual në analet e historisë shqiptare, me një tekst shoqërues që as nuk të lodh (nëse je rishtar në botën e artit apo të historisë), as nuk të mërzit me thjeshtësinë e tepruar (nëse je i fushës). Nuk është kryesisht, them unë, një libër për artin, por një libër për shqiptarët *nëpërmjet* artit, një libër që vë në dukje rëndësinë e merituar të Shqipërisë në kulturën europiane, ndryshe nga karikaturat për shqiptarët që janë bërë shabllone prej vitesh në disa rrethe.

Them se ky libër është një "muze lëvizës", por jo si një album që mund të blihet në dyqanin e Muzeut të Luvrit, për shembull, i cili paraqet të gjitha veprat e muzeut në fotografi. Jo aspak, sepse këtu kemi të bëjmë me një "muze" që nuk ka ekzistuar fare, një trashëgimi veprash të shpërndara në gjithë anët e botës, si vetë diaspora shqiptare. Ku dhe si i paska gjetur të gjitha këto vepra Feridi? –Një koleksion privat në Zvicër, një studio plot rrëmujë në Tiranë, një galeri në Shën Petersburg etj. Mirë paska shkruar Dr. Moikom Zeqo: "Ferid Hudhri i ka kushtuar jetën historisë së artit". Por a dimë të vlerësojmë një përpjekje të tillë? Si mund ta falënderojmë atë dhe familjen e tij, për sakrificat e një jete të kushtuar këtij kërkimi, deshifrimi, interpretimi dhe prezantimi?

Mënyra ime modeste për ta falënderuar ishte përkthimi i librit në anglisht. Ndihesha i detyruar, jo prej presionit nga një mik që respektoj, sepse nuk më vuri presion. (Nuk është mik me interes, të tillët dallohen menjëherë.) Ndihesha i detyruar jo kryesisht ndaj autorit, por ndaj shqiptarëve, të cilët i dua e ndër të cilët banoj. Si mund ta lija këtë kryevepër të pakthyer në *lingua francan* botërore? Si mund ta mbaja si sekret këtë "muze të ri", që ka themeluar Ferid Hudhri nga hiçi?

Nuk mundesha, sepse për mua ky është libri i parë që duhet të vendoset në tavolinën e zyrës së çdo diplomati të huaj në Shqipëri. Ky është libri i parë që duhet të zbukurojë sallonin e çdo shqiptari që banon jashtë atdheut – e variantin anglisht, jo shqip, që të kuptojnë të gjithë mysafirët çfarë dimë ne vetë për historinë dhe kulturën e vendit, me të gjitha gëzimet, hidhërimet, larminë, ngjarjet dhe ngjyrat e realitetit shqiptar, ndër shekujt.



Kopertina e librit me lidhje speciale (Hardcover)

Kopertina e librit me lidhje të thjeshtë (Paperback)



KOMUNIKIM FISNIK MIDIS POPUJVE TË REALIZUAR NËPËRMJET PIKTURËS

Nga Ismail Kadare

(Fragment nga parathënia e botimit të parë)

Në sallonin e pritjes të njërës prej kështjellave mesjetare të Luarës në Francë, të Borgarit në Blezua, midis portreteve të njerëzve e të kapedanëve të shquar të kohës, është edhe një portret i Skënderbeut. Merret me mend se një portret i vendosur në një dhomë pritjeje, në një mënyrë ose një tjetër, tërheq vëmendjen e mysafirëve dhe zgjon bisedën për të.

Portreti dhe biseda për Gjergj Kastriotin në një dhomë kështjelle mesjetare europiane nuk ishte as gjë e rrallë, e as rastësi në shekullin e pesëmbëdhjetë e në shekujt e tjerë më pas. Shqiptarët po derdhnin gjak pikërisht në portat e Europës. Lajmet për të dhe për dyndjet osmane, që ata kishin frenuar bashkë me popujt e tjerë të Ballkanit, vinin të turbullta e plot ankth nga kryeqyteti në kryeqytet, nga kështjella në kështjellë. Flitej me pasion për ndihmën që duhej të jepej, për rrezikun që kërcënonte Europën, për nevojën e organizimit të një kryqëzate të re paneuropiane, në krye të së cilës mund të vihej Gjergj Kastrioti.*

Kaluan kështu mjaft vjet. Bashkë me kalimin e rrezikut, kancelaritë e Europës e harruan shumë shpejt popullin e vogël, që u gjet në qendër të ciklonit. Interesi u zbeh nga shekulli në shekull, pasionin e zëvendësoi indiferenca dhe kjo vazhdoi gjer në formulën cinike të kryeministrit anglez Chamberlen, në mëngjesin e 7 prillit 1939, në çastet kur Shqipëria u pushtua prej fashizmit: "Anglia s'ka ndonjë interes të veçantë në Shqipëri."

Por ndërsa u harrua prej shteteve e kancelarive, Shqipëria nuk u harrua prej letërsisë dhe artit europian. Bajroni, Vivaldi, Delakrua dhe dhjetëra e dhjetëra shkrimtarë, kompozitorë e piktorë të njohur, vazhduan të kërkojnë e të gjejnë motive të papërsëritshme në dramën, tingujt dhe ngjyrat e këtij vendi.

Anglia e Chamberlen-it mund të mos kishte interes për Shqipërinë, por Anglia e Bajronit kishte tjetër mendim. Dhe për cilindo ishte fare e qartë se ky i dyti ishte mendimi i vërtetë i një vendi dhe i një populli.

Vice-versa, populli shqiptar në këngë e në balada prekëse ka folur shpesh për popujt e tjerë të kontinentit. Në këngët e tij nuk mungojnë gëzimet e hidhërimet e tyre, nuk mungojnë as Parisi, as Vjena, as Londra, Athina e Venediku.

Ferid Hudhri na dëshmoi, për herë të parë në mënyrë bindëse, atë komunikim fisnik midis popujve të realizuar nëpërmjet pikturës. Pas një pune të gjatë hulumtuese ai na dëshmoi se me dhjetëra kanë qenë piktorët që, duke udhëtuar nëpër Shqipëri, kanë marrë me vete, për t'i ringjallur më pas në pëlhurë, ngjyrat dhe fytyrën komplekse të saj e të shqiptarëve. Të tjerë që, për arsye të ndryshme, nuk erdhën dot fizikisht, erdhën me mendjen dhe përfytyrimin e tyre, huajtën kostume shqiptare nga kolegët, shpejtuan në studiot e tyre dhe atje, me ndihmën e atyre ngjyrave të paharrueshme, të asaj çka kishin dëgjuar dhe të intuitës që kanë artistët e vërtetë, krijuan tablo të një vlere të pakontestueshme.

E konceptuar si një enciklopedi e kujtesës figurative për historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare, krahas rishikimit të tekstit "Albanians in Art/Shqiptarët në Art" pasurohet vazhdimisht, nga njëri botim në tjetrin. Deri tani janë realizuar tre botime në shqip dhe dy në gjuhë të huaja. Botimi i ri në anglisht është varianti më i përpunuar dhe me përzgjedhjen më të mirë të veprave të artit që e japin më të plotë rrugën e historisë dhe të kulturës shqiptare, si dhe përfaqësojnë arritjet më të mira të krijimtarisë me temë shqiptare të autorëve të huaj dhe të artistëve shqiptarë.

Sipas botimit të Shtëpisë Botuese Onufri (Tiranë, 2018) libri "Shqipëria në Art" i studiuesit Ferid Hudhri i përkthyer në gjuhën angleze këto ditë shpërndahet në Londër dhe në Tiranë. Botimi i ri me titullin "ALBANIANS IN ART" është realizuar nga THE CENTRE FOR ALBANIAN STUDIES, LONDON dhe Onufri në Tiranë (ISBN: 0-9546041-6-4. A full CIP record for this book is available from British Library, London).

Përkthimi është bërë nga albanologu i njohur amerikan David Hosaflook PhD, ndërsa redaktimi nga profesor Tim Wilson, Angli. Ndryshe nga botimi në gjuhën kineze (艺术阿尔巴尼亚,Beijing, 2021), i realizuar nga Shtëpia Botuese e Mësimit dhe Studimit të Gjuhëve të Huaja (Foreign Language Teaching and Research Publishing Co., (FLTRP), ku formulimi grafik ishte krejt i ndryshëm nga varianti shqip, "ALBANIANS IN ART" është më pranë botimit origjinal për sa i përket paraqitjes së veprave të artit. Botimi në gjuhën angleze është pasuruar me disa tablo të reja nga arti shqiptar si dhe nga veprat me temë shqiptare të autorëve të huaj.

Midis tablove që paraqiten për herë të parë në këtë botim është edhe piktura e artistit skocez Colin Morison (1732-1810). Ngjarja e tablosë zhvillohet në qytetin antik të Butrintit. Pasqyrohet çasti kur Enea takohet me Andromakën (*Aeneas arrives at the hill city of Buthrotum,* The Tate Gallery, London). E realizuar në vitin 1760, kjo është nga më të hershme dhe më të çmuara tablo me temë nga trojet shqiptare. Për nga koha e realizimit, vlerat artistike dhe përmasat e telajos, mund të renditet pas afreskut të P. Veronese "Mbrojtja e Shkodrës" (Pallati Dukal, Venecia 1577), tablove nga V. Carpaccio për "Scuola degli Albanesi " (Venezia,1503-1504) dhe para pikturës së E. Lear-it "Mali i Tomorit, Shqipëri" (1872, Koleksioni Lord Rothschild, Londër) si dhe tablove të tjera nga autorë të shquar botërorë si Rembrandt (1606-1669), G. Bellini (1429-1507), Van Dyck (1599-1641), N. Pousin (1594-1665), Van Mour (1671-1737), E. Delacroix (1798-1863), C. Corot (1796-1875), A. Decamps (1803-1860), L. Gérôme (1824-1904), F. Lewis (1805-1876), Van Gogh (1853-1890), P. Jovanovitc (1859-1957), C. Wodville (1856-1927) etj., që kanë realizuar shumë e shumë vepra me temë shqiptare.

Përballë pikturës së C. Morison (f. 104-105) është vendosur litografia e piktorit anglez Poer Beresford (1831-1906), sipas vizatimit të realizuar në Butrint në vitin 1855, plot 95 vjet më pas. Në kohët midis këtyre dy veprave, dhe në vitet më pas, janë krijuar disa dhjetëra vizatime, gravura, litografi, akuarele dhe tablo me ngjyra vaji me motive nga Butrinti prej artistëve tjerë të njohur si Louis Dupré (1819), Henry Cook (1835), Joseph d'Estournel (1844), Edward Lear (1857), Felix Ziem (1857), Smith O'Hara (1859), Ernest Gambier Parry (1889), Iginio Epicoco (1929), Adelmo Manna (1931), Luigi Piffero (1940), Umberto Marchetti (1943) etj.

Kompozim i profesorit të Oxford-it, (studiues i Edward Lear), Tim Wilson: "*Edward Lear duke biseduar me autorin Ferid Hudhri në sallën* "Edward Lear", te Sarajet, Tiranë, 2011

SHQIPJA DHE HUNGARISHTJA, DY NGA GJUHËT UNIKE TË EUROPËS

Bisedë e gazetares Mimoza Hasani Pllana, me Krisztián Csaplár-Degovics, albanolog dhe historian hungarez

Marrëdhëniet shqiptaro-hungareze janë shumë të hershme, porse dokumentet e shkruara për gjuhën shqipe nga studiuesit hungarezë, ndërkaq janë të vona. Kur kujtojmë miqësitë në mes dy popujve duhet të nisemi nga ngjarjet më të mëdha, si: 1. Bashkëpunimi në mes heronjve kombëtarë kundër perandorisë Osmane, Gjergj Kastriot Skënderbeu i shqiptarëve dhe Huniadit të hungarezëve. 2. Përkrahja e monarkisë Austro-Hungareze për themelimin e shtetit shqiptar. 3. Miqësia e madhe mbretërore që ka lidhje me martesën e Mbretit Zog me Mbretëreshën Geraldinë. 4. Përkrahjen e sërishme nga Hungaria për pavarësinë e shtetit të Kosovës, etj. Me gjithë këto ngjarje, hungarezët janë ndër kontribuesit më të mëdhenj europianë për studimet në fushën e albanologjisë. Nga dokumentet e shkruara për gjuhën shqipe, pas albanologëve gjermanë dhe austriakë, renditen edhe albanologët hungarezë. Nga koha e monarkisë austro-hungareze, albanologu dhe historiani hungarez i kohës së sotme, Krisztián Csaplár-Degovics, vlerëson dhe kujton punën e albanologëve: Karl Kaser, Peter Bartl, Konrad Cleëing, Oliver J. Schmitt, Jonida Xhyra, Kurt Gostentschnigg, Eva Anne Frantz, Bardhyl Demiraj, si shumë të rëndësishme për krijimin e pikëpamjeve të tij për gjuhën shqipe. Më pas, ai kujton mësimet e drejtpërdrejta të marra nga albanologu i shekullit tonë dhe miku i madh i shqiptarëve Istvan Schuts. Schuts (sipas Csaplár-Degovics), përmes rrëfimeve dhe anektodave për popullin dhe kulturën shqiptare, zgjonte kureshtjen e studentëve hungarezë, për shqipen dhe shqiptarët. Më pas, gjuha dhe kultura shqipe, me veçantinë e saj, arrin t'i tërheqë dhe magjepsë studiuesit seriozë të çështjeve ballkanike, sikur Csaplár-Degovics. Ai fillimisht u impresionua me organizimin fisnor të shoqërisë shqiptare, si dhe me gjuhën shqipe, të cilën e quan "gjuhë ishull" (sikur edhe gjuhën hungareze), gjë që e bën territorin shqiptar, zonë unike në Ballkan. Këto dy elemente fillestare u bënë motive të forta që Csaplár-Degovics, të thellojë studimet në fushën e marrëdhënieve shqiptaro-hungareze gjatë shekujve dhe tani të redaktojë një libër studimor mbi marrëdhëniet historike, politike, kulturore dhe shkencore shqiptaro-hungareze, prej shekullit 15 e deri më tani. Libri është vlerësuar si tepër i rëndësishëm nga qeverija aktuale hungareze, andaj mbështetet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë.

Mimoza Hasani Pllana: Çfarë ju ka motivuar kaq shumë sa të mësoni gjuhën shqipe?

Krisztián Csaplár-Degovics: Pikësëpari gjithmonë kam pasur dëshirën që të jem historian, që merret me historinë e Europës Lindore dhe gjithmonë kam qenë në kërkim të një historie të caktuar kombëtare, interesante në një kuptim të gjerë, për studimin e së cilës kërkohet përgatitje dhe shkathtësi shkencore specifike. Në universitet jam marrë me historinë polake, sllovake dhe rumune, në përpjekje për të gjetur një periudhë, personalitet apo territor intrigues për t'ia dedikuar përpjekjet e mia shkencore – por ende pa sukses. Pas disa muajve dhe viteve humba interesimin tim për këto vende. Së dyti, unë kam studiuar shkencat arkivore në universitet (1997-2002). Më 1999 kam marrë pjesë në një trajnim në Arkivat Kombëtare të Vjenës organizuar nga Delegacioni Arkivor i Hungarisë në Austri. Ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme për mua dhe u dashurova me dokumentet që ofronin Arkivat Kombëtare të Austrisë. Së treti, u ndesha me historinë shqiptare shumë vonë. Ka qenë viti 1999 kur isha duke lexuar monografinë e profesorit austriak Karl Kaser mbi fiset shqiptare (Hirten, Kampfer, Stammeshelden). Kam qenë i fascinuar të mësoj se 4-500 kilometra larg nga Hungaria ekzistonte një shoqëri mirë e organizuar fisnore në fillim të shekullit. Në një moment kur sapo kisha përfunduar së lexuari librin e Kaser, u ndesha me emrin e Nopças dhe dokumentet për të në Arkivat kombëtare vjeneze. U dashurova me personalitetin e tij dhe fillova së shkruari tezën e magjistraturës mbi aktivitetin e Nopças më 1911 në Shqipërinë e Veriut, duke u mbështetur në burimet arkivore të papublikuara të Arkivës kombëtare austriake. Pas diplomës së parë, vendosa që të merrem me historinë shqiptare me intensitet të shtuar dhe në mënyrë profesionale: në muajt e parë kur fillova studimet doktorale e vizitova prof. Schutzin për të marrë pjesë në seminarin e tij gjuhësor.

M.: Sikur edhe gjuha hungareze edhe gjuha shqipe është e veçantë, jo e lehtë për t`u mësuar dhe për t`u folur derisa nuk jeton në vendet shqipfolëse. Sa mbani kontakte fizike me shtetet europiane ku gjuha shqipe është gjuhë zyrtare: Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e zi?

K.C.D.: Gjuha shqipe i takon familjes së gjuhëve indo-europiane, kështu që marrëdhënia me strukturën gramatikore të saj është e lehtë. Vështirësitë e të mësuarit së shqipes rrjedhin nga fjalori i saj i veçantë dhe dialektet e së folmes. Që nga viti 2004 lexoj publikimet e historiografisë shqiptare (nganjëherë përdor fjalorin), letërsi, veprat e intelektualëve shqiptarë etj. Kështu që mendoj se kapacitetet e mia lexuese janë të mira. Kam studiuar historinë e Europës juglindore në Minhen dhe Vjenë (2002-2004) dhe që nga ajo kohë kurrë nuk i kam shkëputur kontaktet e mia me mësuesit dhe miqtë shqiptarë; ne komunikojmë në gjuhën gjermane dhe shqipe. Në tri vitet e fundit kam marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare në Tiranë dhe Prishtinë dhe kam filluar të mbaj korrespondencë me historianë dhe shkencëtarë shqiptarë, të cilët nuk i kam njohur më parë.

M.: Fushat tuaja të studimit i përkasin kërkimeve politike, historike, kulturore të popullit shqiptar, nga të cilat keni marrë informacione edhe për gjuhën, traditën kulturore, historinë dhe zakonet e shqiptarëve, andaj a mund të na thoni si e çfarë e dallon gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar në mesin e gjuhëve dhe popujve ballkanikë?

K.C.D.: Ngjashëm sikur gjuha hungareze, gjuha shqipe është një "gjuhë ishull". Në fqinjësi të saj nuk ka gjuhë të tjera që kanë ngjashmëri me të. Për shkak të këtij 'pozicioni ishullor' bota shqipfolëse krijon një territor të mbyllur në Ballkan dhe nuk është e vështirë që të dallohen veçoritë kryesore ndërmjet gjuhës shqipe me gjuhën greke dhe sllave. Nga pikëpamja e historianëve, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjuhëve të vendeve fqinje: ka burime të pakta me vlerë, të shkruara në gjuhën shqipe para fundshekullit të 19-të.

M.: Historia e albanologjisë njeh emra të shquar albanologësh nga koha e Autro-Hungarisë dhe sot.

Kujtojmë dy albanologët e dalluar, një nga të parët Franz Nopcsa dhe Istvan Schuts, kontribuesin e madh të kohës sonë. A mund të na thoni a ka ndikuar vepra e tyre në studimet tuaja?

K.C.D.: 'Mësuesi i parë' pa dyshim ka qenë Nopça, pastaj Lajos Thallóczy të cilin shoqëria shqiptare nuk e njeh mirë. Nopçja ka qenë shkencëtar i madh, ndërsa Thallóczy ka luajtur një rol të rëndësishëm në proceset e formimit të kombit dhe shtetit shqiptar ndërmjet viteve 1896 dhe 1916. Pas njohjes me Nopçan dhe Thallóczin, kanë qenë profesorët, kolegët dhe miqtë e mi austriakë, bavarezë dhe shqiptar në Mynhen, Vjenë dhe Grac të cilët ma prezantuan albanologjinë austro-hungareze (Karl Kaser, Peter Bartl, Konrad Cleëing, Oliver J. Schmitt, Jonida Xhyra, Kurt Gostentschnigg, Eva Anne Frantz, Bardhyl Demiraj). Ata më ndihmuan t'i artikuloj pikëpamjet e mia apo të shndërrohem në një pasardhës hungarez të albanologjisë austro-hungareze. Unë mësova gjuhën shqipe vetëm një semestër nga prof. Schutz. Në vend të mësimit të gjuhës, ai preferonte që të tregonte anekdota mbi kulturën dhe shoqërinë shqiptare. Për këtë arsye unë shkova në Mynhen, që ta mësoj gjuhën shqipe dhe albanologjinë. Në përgjithësi, unë kam pasur profesorë austriakë, gjermanë dhe shqiptarë, dhe jo profesor Shutzin. Edhe pse nuk llogaritem si student i prof. Schutz, bëj shumë përpjekje që trashëgimia e tij të vlerësohet dhe të kujtohet si në Hungari, ashtu edhe në vendet ka banojnë shqiptarët. Kam respekt për aktivitetin e tij jetësor dhe shkencor.

M.: Të flasim pak për njërin ndër albanologët më të njohur në Europë në shek. XX., Istvan Schuts, që la pas vetes studime monumentale lidhur me prejardhjen e gjuhës shqipe. A mund të na kujtoni z. Schuts sipas njohjes suaj?

K.C.D.: Aktiviteti shkencor dhe jetësor i prof. Schutz ka ngjallur debate në Hungari. Ai ka qenë një shkencëtar i 'vetëshpallur (vetëbërë)' dhe një linguist autodidakt. Për shkak të hendeqeve shkencore të tija, sipas meje, linguistët hungarezë kanë refuzuar ta pranojnë në mesin e tyre. Publikimet në hungarisht të Schutzit kanë qenë cak i sulmeve shkencore në kolumne në revista të njohura hungareze. Thënë të vërtetën, ai nuk ka mundur t'i bindë kritikët hungarezë për pikëpamjet e tij. Kjo ka qenë ndër arsyet kryesore pse ai filloi t'i publikojë punimet e tij shkencore në gjuhë të huaja dhe për këtë arsye ai është ndjerë më i respektuar në revista ndërkombëtare shkencore. Sa i përket sfondit të njohurive historike, personalisht i vlerësoj qëndrimet e tij me një dozë kritike. Librat në hungarisht të prof. Schutz, që kanë trajtuar të kaluarën historike të Ballkanit, rrallëherë janë të dobishme për studentët dhe historianët. Në anën tjetër, këto libra kanë qenë ndër librat e para në gjuhën hungareze, të cilat kanë hulumtuar periudhën më interesante dhe më së paku të hulumtuar të Europës Juglindore para fillimit të mileniumit të ri. Për ta përmbledhur, nëse dikush dëshiron ta vlerësojë të kaluarën shkencore të Schutzit ai duhet ta hulumtojë ndikimin e tij në shoqërinë e shkencëtarëve shqiptarë. Besoj se ndikimi i tij dhe kujtesa për Shutzin, po ashtu ka një anë emocionale, përbrenda historisë së albanologjisë. Prof. Schutz filloi të merret me albanologji, filloi të komunikojë me shkencëtarët shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëra në një periudhë të rëndësishme, atëherë kur shqiptarët trajtoheshin si qytetarë të rangut të dytë në Jugosllavi dhe nga një botë e ndarë nga lufta e ftohtë. Prof. Schutz i motivuar dhe i shtyrë nga personaliteti i tij, interesimet e tij të vazhdueshme, gjithmonë i ka konsideruar shqiptarët, kulturën dhe gjuhën e tyre si vlera të përgjithshme të njerëzimit (dhe kjo është arsyeja pse aktiviteti i tij jetësor mund të jetë pjesë e traditave të mira të albanologjisë).

M.: Lidhjet shqiptaro-hungareze janë të hershme, nga koha e dy figurave kombëtare Skënderbeut dhe Hunyadit, për të vazhduar në kohën tjetër të përkrahjes së madhe që Austro-Hungaria dha për krijimin e shtetit shqiptar, pastaj me lidhjen martesore të Mbretit Zog me vajzën (Mbretëreshën Geraldinë) e njërës prej familjeve të njohura hungareze, Apponyi. Në shekullin që po jetojmë (XXI), Hugaria radhihet nga shtetet e para që njohu pavarësinë e Kosovës. Çfarë do të veçoni nga marrëdhënie shqiptaro-hungarezebrenda periudhës tuaj të studimeve?

K.C.D.: Sa i përket lidhjeve historike shih pjesë në pyetjen e 8-të. Jam dakord me ju se ngjarjet kryesore që kanë shënuar lidhjet hungarezo-shqiptare ndërlidhen me bashkëpunimin e Skënderbeut me Huniadin, lindjen e albanologjisë në Perandorinë Habsburge (1850), rolin austro-hungarez në proceset e formimit të kombit dhe shtetndërtimit tek shqiptarët (1896-1960), ekspeditat hungareze në territoret shqiptare (1916-1918), martesa ndërmjet mbretit Zog dhe Geraldinës, marrëdhënieve shkencore 1945-1955 dhe njohjes së pavarësisë së Kosovës.

M.: A mund të na thoni çfarë jeni duke punuar tani në kontekst të studimeve ballkanike?

K.C.D.: Tani jam duke redaktuar një liber shkencor mbi marrëdhëniet historike, politike, kulturore dhe shkencore shqiptaro-hungareze (prej shekullit 15 e deri më tani). Dymbëdhjetë studime, ku paraqiten përpjekje për të dhënë detaje mbi situatat konkrete historike në të cilat historitë kombëtare të shqiptarëve dhe hungareze janë përpjekur (Skënderbeu dhe Huniadi; familja Arianiti në Hungarinë otomane të shekullit të 16-të; aktiviteti i Gjergj Balshës në Hungari; Pjetër Mazreku; Toma Raspassani; Lajos Thallóczy dhe formimi i kombit shqiptar; detashmenti austrohungarez në Shkodër më 1913; Nopcja në kampanjën ushtarake austro-hungareze në vitin 1916; 25 vjetori i pavarësisë në Tiranë më 1937; mbretëresha Gjeraldinë; marrëdhëniet shqiptaro-hungareze gjatë luftës civile greke 1946-1949; pavarësia e Kosovës dhe Hungaria) dhe katër përmbledhje mbi lidhjet shkencore (historia e albanologjisë hungareze; marrëdhëniet arkeologjike ndërmjet Hungarisë dhe Shqipërisë; botanistët hungarezë në territoret e banuara me shqiptarë; albanologjia dhe linguistët hungarez). Ky libër studimor dhe shkencor është shkruar nga historianët dhe shkencëtarët më të shquar hungarezë dhe financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Hungarisë. Në anën tjetër, synoj që të shkruaj një monografi mbi shtetin e parë shqiptar (1912-1914) nga perspektiva ndërkombëtare dhe globale.

Krisztián CSAPLAR-DEGOVICS: u lind më 1976. Në vitin 2000, mbaroi studimet për Historinë e Përgjithshme në Universitetin e Budapestit, Eötvös Loránd. Më 2003, mbaroi studimet në Shkencat e Arkivit, në po të njëjtin Universitet, ku edhe vazhdoi studimet doktorale në fushën e Shkencave Historike, programi: Historia e Europës Lindore të shekullit XIX dhe XX, të cilat i mbaroi në vitin 2008. Kërkimet shkencore të CSAPLAR-DEGOVICS, i përkasin Historisë së Shqipërisë, Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë, si dhe studime të tjera të lidhura me politikat ballkanike të monarkisë së Austro-Hungareze. Nga arritjet akademike, veçohet puna e tij si këshilltar i lartë i kërkimit dhe udhëheqës i ekipit kërkimor për studime të Europës Juglindore në Akademinë e Shkencave në Hungari, si asistent professor në Departamentin e Historisë së Europës Lindore në Universitetin e Budapestit, Eötvös Loránd. Deri tani, ka publikuar me dhjetëra punime shkencore në fushën e studimeve të marrëdhënieve kulturore dhe historike të vendeve të Ballkanit. Është anëtar i "Shoqatës së Studimeve Austriake", anëtar i "Institutit Shqiptar" në Mynih, anëtar i komisionit të përbashkët të historianëve bullgaro-hungarez, etj. Është përfitues i disa bursave të studimit në vende të ndryshme europiane. Në vitin 2008, është nderuar me çmimin Péter Hanák, që ndahet për studiuesit e rinj të historisë së Europës Qendrore

LIBËR QË SJELL NJË PËRVOJË TË RE NË TRADITËN TONË

Nga Emin AZEMI



E kisha lexuar dikur më herët, dhe nuk e di pse më kishte mbetur në një skutë të kujtesës, një thënie e shkrimtares dhe eseistes kroate Dubravka Ugreshiq: "Të prodhosh libra, s'do të thotë të prodhosh letërsi". Mirëpo, derisa e lexoja dorëshkrimin e Gani Bytyçit "Kuvendim i pambaruar me Anton Nikë Berishën", që për mua nuk ishte ndonjë e papritur, pasi që në njëfarë mënyrë edhe vetë isha bërë bashkëpjesëmarrës i tërthortë në procesin e këtij libër-bërjeje, megjithatë m'u desh t'i bëja një përshtatje thënies së shkrimtares kroate.

"Disa tema e ide kishin kaluar nëpër një proces krijues, edhe pa u bërë ende libra".

Ky do të ishte, afërsisht, varianti i përmbysur i thënies së Ugreshiqit, që do t'i shkonte pak a shumë natyrës së krijimit të këtij libri, dhe nuk do të them asgjë të re nëse zbuloj, tashmë kur ai ndodhet në duart e lexuesit, pra edhe në duart e kryeprotagonistit tonë - prof. Anton Nikë Berishës, se kam lundruar nëpër një ndjeshmëri të ngrohtë e tepër miqësore në momentin kur shkrimtari dhe piktori, Gani Bytyçi, kishte vendosur të ndante me mua një fshehtësi, që duhej ta dinim vetëm unë dhe ai.

Pra, ishim marrë vesh me Ganiun që të thyejmë një rutinë në traditën e shënimit të ditëlindjes së studiuesit, shkrimtarit e mikut tonë të dashur, prof. Anton Nikë Berishës, duke i dhuruar atij një libër dedikues për ditëlindjen e tij, i cili do të ndërtohej mbi një proces të natyrshëm bashkëbisedimi në mes tij dhe Ganiut. Pra, kjo ishte ajo "dhurata" (torta) në formë libri me të cilin ne donim disi të ndërhynim, pak a shumë, në mënyrën e tryezës së një feste, që njeriu e shënon një herë në vit.

Ndoshta, fillimisht, edhe Ganiu nuk e ka pasë idenë se bashkëbisedimi me prof. Antonin, mund të të nxirrte në një vokacion shkrimi që krejt pahetueshëm të grishë të bësh libër, prandaj isha munduar që ta inkurajoj, që sipas një ritmi dhe ecurie jo të rëndomtë, të fillojë ta ndërtojë strukturën e librit të tij, bazuar në ato detaje që atij do t'i bënin përshtypje nga bisedat telefonike me prof. Antonin, e që ende, për shkaqe objektive, nuk e ka përmbyllur harkun e plotë përmbajtësor.

Mbase krejt kjo ide u ngjiz duke ia bërë një "tradhti" të vogël prof. Antonit: ai nuk po e dinte se bashkëbisedimi me të do të shndërrohej në një materie të strukturuar tekstore që do të futej brenda kopertinave të një libri.

Nuk është hera e parë që libra të tillë bëheshin mbi modele të ngjashme bashkëbisedimi, por rrallë herë kishte ndodhur që bashkëbiseduesi të mos dinte se po bëhej subjekt i një libri. Pra, prof. Antoni jo vetëm që nuk e dinte se Ganiu me të po bënte një "xhiro të gjatë shëtitjesh" nëpër tema e ide, nëpër vepra e autorë, nëpër kohë e hapësirë, që nga Aristoteli e deri te Mikelangjeloja, që nga Antika deri te Renesanca, që nga De Rada deri te Anton Pashku, por ai as që mund ta merrte me mend se në një distancë disa mijëra kilometërshe, përmes telefonit, po jepte "leksione falas" nga çështje të studimit të letërsisë, nga estetika, nga filozofia e arti. Dhe, Ganiu, si një "student i përkushtuar" po shënonte në shiritin e kujtesës dukuritë më të qenësishme të bashkëbisedimit për arsye se çdo imtësi, çdo ndërhyrje dhe çdo mikrongjarje atij do t'i hynte pastaj në punë për të ngritur në këmbë atë krijesë që më vonë do të merrte formën e librit.

Gjithsesi, ky bashkëbisedim nuk do të mund të ishte kreativ e intelektalisht i mbathur mirë për nga përmbajtja dhe stili, sikur të mos ekzistonte që në thelb të gjakimit edhe një prirje e vetë autorit për të nxitur e shkoqitur tema e ide që atij i janë dukur më me vlerë e më të rëndësishme.

Mund ta marrim me mend se si para çdo bashkëbisedimi, atij i është dashur të sistemojë në kutinë magjike të laboratorit krijues dijet teorike dhe përvojën e tij krijuese, në mënyrë që biseda të plotësonte disa nga kriteret për t'u konsideruar të denjë për t'u përfshirë e për të bërë pastaj një libër.

Meqë e kam ndier nga afër drithërimën e asaj që prodhonte ngacmime tek autori pas çdo bashkëbisedimi me prof. Antonin, nuk e kam pasur vështirë ta distancoj për pak çaste Ganiun nga qarku i ngushtë i subjektivizmit që krijon miqësia, dhe ta krahasoj me një Cvajg, Kapuçinski, Falaçi etj. të cilët gjatë procesit të ndërtimit të subjekteve e profileve njerëzore në reportazhet e tyre brilante, kishin përdorur letërsinë si një "daltë" pa të cilën nuk do të formësoheshin disa nga pasazhet brilante të rrëfimit. Edhe tek Ganiu, ngjashëm, letërsia u përdor si një "daltë" për të nxjerrë nga shiriti i gjatë i bashkëbisedimit bërthamat më të pastra fabulore, që u modeluan sipas një arkitekture të menduar mirë tekstore.

Metodologjia e bërjes së këtij libri është bazuar në formën e një ditari që autori e thurte për çdo ditë, duke krijuar një pëlhurë të gjerë rrëfimi. Si mjeshtër i ngjyrave dhe i tonaliteteve që dalin prej tyre, Gani Bytyçi ka ditur të nxjerrë një portret, pak a shumë të panjohur, por tepër të ngrohtë e njerëzor, të prof. Anton Nikë Berishës. Atij i është dashur të ndjekë disa linja rrëfimi për të sistemuar gjithë "armaturën" në shtyllat kryesore mbi të cilat qëndron ky libër.

Një prej atyre shtyllave, sipas Ganiut, ka qenë ideja që përmes bashkëbisedimit me njërin nga studiuesit dhe shkrimtarët më të shquar bashkëkohor të letrave shqipe, Anton Nikë Berishën, të përçojë tek lexuesi disa nga përvojat krijuese dhe dijet teorike letrare të tij. Kjo del pahetueshëm edhe nga qëllimi i autorit që bashkëbiseduesin e tij ta quaj një "enciklopedi e gjallë letrare", i cili në tryezën e punës mbante shkrimtarët e preferuar, ose "mbretërinë e tij letrare".

I rrethuar nga kjo mbretëri, prof. Antoni në sytë e Gani Bytyçit dilte një eruditi për arsye se "sa herë të flasësh me të, ai nxjerr një detaj nga jeta, një varg nga poezia, një nuancë nga kuptimi".

Një shtyllë tjetër mbi të cilën rëndon pesha e përsiatjes filozofik e estetik të këtij libri, është ideja e autorit që përmes bashkëbisedimit kreativ me prof. Antonin të depërtohet edhe në vet procesin e ndërlikuar të krijimit. Ky mbase është edhe një përfitim mjaft domethënës edhe për letrarët e rinj, të cilët do të mund të mësonin detaje të panjohura nga përvoja krijuese e hulumtuese e prof. Antonit, sepse ai gjatë bashkëbisedimit kishte nxjerrë disa nga "sekretet" e tij të të shkruarit, por dhe të autorëve që ai i kishte njohur personalisht.

Një përfitues i kësaj "shkolle krijimi" del të jetë edhe vet autori i këtij libri, Gani Bytyçi, i cili edhe e pranon se gjatë bisedës me Profesorin (gjithkund në libër e shkruar me gërmë të madhe), ai kishte mësuar gjëra me vlerë që do t'i shërbenin në përvojën e mëpastajme krijuese, po njëherit edhe vetë e dëshmon një dije e aftësi për t'i thënë e shtruar gjërat.

Ky libër, që përmban në vete elemente të kronologjisë dhe ditarit, i shkruar me pasionin e autorit që është tepër kureshtar për fshehtësitë e padukshme të artit dhe të gjithë asaj që e bën një vepër të plotë për nga përmbajtja, ideja, teknika e krijimit, do të shënojë edhe një sukses në eseistiken tonë bashkëkohore.

"Sa herë që bisedoja me Profesorin, doja që ai të fliste më shumë". E thotë këtë autori i librit, teksa depërton në shtresat më komplekse të problematikave që ai i mbarështonte gjatë bashkëbisedimit, duke i dhënë prof. Antonit edhe një atribut me plot meritë – atë të "ciceronit" në eksplikimin e hapësirave të paana të letërsisë, të artit, të estetikës e të filozofisë. Pra, autori dëshironte që "Profesori të fliste më shumë", ndonëse, siç e thotë ai, "kur flasim me Profesorin, asnjëherë nuk e dimë se kur fillonte biseda dhe kur mbaronte".

Gani Bytyçi, përmes këtij libri, sjell një përvojë të re tekstore, që do t'u shërbejë edhe autorëve të tjerë për t'i shndërruar komunikimet e tyre me krijuesit në testamente shpirtërore.

Këtë angazhim intelektual e krijues të autorit, Gani Bytyçit, do duhej kuptuar edhe si mirënjohje për përkushtimin e pareshtur dhe punën e madhe të Anton Nikë Berishës, në fushën e krijimtarisë dhe të studimeve letrare. Them kështu edhe për faktin se mos vëmendja shoqërore e institucionale ndaj njerëzve të dijes është shndërruar në një 'infarkt' të ndërgjegjes sonë kolektive, e cila assesi nuk mund të shërohet nëse nuk fillojmë ta bëjmë mirënjohjen pjesë të mendësisë sonë civile. Pra, me të drejtë Gani Bytyçi, nxjerr një klithmë njeriu të shqetësuar, në formë të dilemës intelektuale se "përse ne sikur kemi frikë nga mirënjohja dhe nga ndriçimi i punës së të tjerëve?"

Në përmbyllje do të doja të shpreh edhe njëherë kënaqësinë e të qenit tërthorazi pjesë e një procesi krijues, të cilin autori me shumë sukses e kurorëzoi, duke na sjellë një kontribut me vlerë në kulturën e respektit dhe konsideratave ndaj prof. dr. Anton Nikë Berishës.

Shkup, 5 gusht 2021

Romani "Kështjella", Ismail Kadare

STRUKTURA NARRATIVE DYLINJËSHE NË NJË METAFORË QËNDRESE

(variant i shkurtuar nga një studim i gjatë)

Nga SHAZIM MEHMETI

Shkrimtari Ismail Kadare, më shumë se çdo shkrimtar tjetër shqiptar, në strukturat e veta letrare e ka bërë qendërsimin e ngrehinës, madje duke bërë dendur një lloj mbishpirtëzimi të saj. Ky mbishpirtëzim i ngrehinave, në prozën e tij vjen i gjallëruar, funksional, sa brenda veprës së tij të njëjtat gjallërojnë parësisht si ngrehina kulti.

Romani "Kështjella" është një nga veprat e Kadaresë ku preket artistikisht tema historike. Për dallim nga autorë të tjerë që e kanë realizuar këtë lloj teme, Kadareja përdor një tjetër qasje realizuese. Struktura narrative te ky roman i Kadaresë zhvillohet e vendosur mbi dy linja paralele. Linja e parë rrjedh duke e zbërthyer qëndresën brenda kështjellës, përmes rrëfimit ndjesor të njërit nga mbrojtësit e brendshëm të kështjellës. Linja tjetër rrjedh duke e zbërthyer luftën për pushtimin e kështjellës, me gjithë dinamikën, dhe me gjithë ngulmimin e pushtuesit nga jashtëkështjella.

Kështjella, në këtë strukturë narrative funksionon si një paralele e "mesit" që lëviz e shtrihet mes dy paraleleve të dinamizuara, por që e fiton qendërsimin në ligjëratën letrare. E njëjta bëhet qendra e gjithë rrëfimit, dhe e fiton epitetin e ngrehinës ku varet besimi. E shtruar në narracion, përgjatë gjithë strukturës narrative kështjella funksionon si kult, si besim.

Në këtë roman të Kadaresë bie fort në sy tendenca e shkrimtarit për sendërtimin e atmosferës narrative. Në thellësi të romanit, ndeshemi shpesh me përshkrime shumë bindëse të atmosferës në kamp, ku reflektojnë atributshëm përshkrime brendësore të personazheve, dhe përshkrime jashtësore, por që janë të ndërtuara me një teknikë narrative shumë të admirueshme.

Kadareja, në gjithë strukturën e romanit "Kështjella" operon me fenomenin e shtrirjes së vazhdueshme të antipodeve. Struktura narrative dinamizohet pikërisht mbi këtë shtrirje të vazhduar, mbi këtë megamekanizëm letrar, që në fakt është një përbërje e fituar me kombinimin dhe me vënien në lojë të shumësisë së mjeteve letrare si krahasimet, paralelizmat, analogjitë, simbolet, hiperbolat, parabolat, litotat, konvencionet, epitetet, metaforat, etj. Brenda këtij megamekanizmi letrar, këto mekanizma individualë gjallërojnë sipas ligjshmërive të ligjërimit për të cilat është parapërcaktuar autori.

Për pyetjen, përse Kadareja në shumë nga strukturat e veta narrative, ka vendosur në qendërsime ngrehinat, ka një përgjigje, dhe përgjigja është shumëdimensionale, por parësisht ka të bëjë me një arsye qenësore. Kjo arsye lidhet me faktorët që kanë ndikuar në formimin e Kadaresë si individ dhe si shkrimtar, dhe në faktorët që ai synon t'i vë në përdorim si mekanizma konkretë në letërsinë e tij. Këtu kanë hisen e vet ndikesa e përbrumësisë historike në formësimin e tij, lënda ndëgjegjësore kolektive e shqiptarëve për rëndësinë dhe për besimin që kanë ata për ngrehinën si objekt mbijetese apo shpëtimi gjatë shekujve, si dhe informacioni i thelluar i shkrimtarit mbi këtë fakt. Këtu ka hisen e vet edhe afiniteti i shkrimtarit për krijimin e sistemeve dhe strukturave narrative me vertikalitet qëndrues, ku domosdo praktikohet me: boshtin qendërsues rreth të cilit sillet gjithçka, sipas një ligjësie centrifugale të zhvillimit të narracionit; skeletimin si konstrukcionin bazë mbi të cilin mbështetet me gjithë masën e vetë struktura narative, dhe; masën brumësore apo mishin strukturor në dukje, me gjithë format, detajimet, tenet, ngjyrimet artistike, prurjet brumësore estetike, metafizikën, etj.

"Kështjella" rezulton si roman i atmosferës, ku gjallërojnë vektorët e përkushtimit të personazheve në vijë të pushtimit të saj. Pothuajse në gjithë shtrirjen e rrëfimit në roman, mbizotëron simbioza e formimit të karakterave të personazheve dhe vendosjes së atmosferës. Shikuar nga ky kënd, del në pah fakti se, atmosferës në rrëfim i ka ndihmuar fort skalitja e karakterave të personazheve. Janë pikërisht ato karaktere që flasin e bëjnë lëvizje të tilla, duke lënë pas vetes një përmbushje të vërtetë të atmosferës.

Në këtë strukturë ligjërimore bie në sy edhe dukuria specifike e emërtimit të personazheve. Pothuajse të gjithë kryekomandantët te ky roman, në emërtimet e tyre kanë diçka nga metalet, nga bishat e egra, nga pluhuri i marshimeve, nga vetëtimat dhe nga gjërat tjera goditëse. Autori, me këtë specifikë emërtimi, me lehtësi arrin të përcjellë tek lexuesi nga diçka prej karakterit të personazheve, duke e bërë kështu më të lehtë komunikimin e lexuesit me brendinë e narracionit.



E një rëndësie të veçantë në strukturën e këtij romani është gjuha që autori vë në gojët e personazheve. Kjo gjuhë është e ndërtuar mbi përvojën mendësore, ndjesore e narrative të autorit, dhe konsolidimi i kësaj gjuhe ndodh mbi bazën e karaktereve të personazheve. Ashtu si janë të projektuar personazhet, ashtu ndodh platformimi i karaktereve, e për rrjedhojë edhe gjuha e tyre.

Brenda kësaj strukture narrative, gjithçka është në vijë të të paraprojektuarës, pavarësisht faktit se ky roman është një strukturë e ndërlikuar, me dinamikë shumëplanëshe e me personazhe delikate. Mbi të gjitha, si shumë e konsoliduar del gjuha e kështjellarit që referon në parakapitujt e romanit nga fillimi e deri në fund të romanit. Gjuha e tij është gjuha e një atdhetari të përkushtuar, ndjesor e me mprehtësi mendimi.

Detajizimi i rrëfimit në këtë roman, është sipas një determinimi pothuajse matematikor. Matrica e rrëfimit është polivalente, me gamë shumë të gjërë shprehimore. Elementët e kësaj matrice letrare janë shumë përmbajtësorë, të dinamizuar, dhe lëvizin brenda saj me logjikën e ndjesores së përsosur.

Në këtë roman, në zemrat, në mendjesinë e në sytë e kështjellarëve shqiptarë, kështjella konfiguron si objekt mbijetese. Ata gjithë besimin dhe gjithë shpresën për shpëtim e kanë mbështetur mbi kështjellën e shpëtimit. Për ta, kështjella domosdo është kult.

Figura e Skënderbeut në këtë strukturë narrative të Kadaresë, nuk është e vënë në syrin e dritës. Pothuajse në gjithë srtukturën ajo është e lënë në hijen e nënkuptimit. Ai në narracion

është personazhi i veshur me petkun e mistikes.

Strukturën narrative në romanin "Kështjella", Kadareja e udhëheq sipas ligjshmërisë së sipërpërmendur edhe kur bëhet fjalë për brendakështjellën si objekt. Gjithë çka ligjërohet për brendinë e kështjellës dhe veprimet brenda saj, është sipas ligjshmërisë narrative me të cilën operohet rreth figurës së Skënderbeut, por me një rreze paksa më të zgjëruar të ligjëratës narrative.

Në këtë roman të Kadaresë, siç mund të vërehet, ka një "bashkëjetesë" kultesh. Kulti i ngrehinës brenda strukturës narrative bashkëfrymon me kultin e jetës, kultin e bukës, kultin e vdekjes, kultin e luftëtarit, kultin e ujit të pijes, kultin e gruas, kultin e besës, kultin e udhëheqësit, kultin e lirisë, etj.

Kadareja dëshmon, edhe përmes kësaj strukture narrative, se është një njohës i spikatur i poliedrit shumëplanësh të jetës shqiptare në faza të ndryshme kohore, dhe kjo është përparësia e tij, arma e tij shkrimtareske. Ai, në masë të madhe shërbehet artistikisht me lëndën historike.

Karakteristikë dominante në strukturën narrative të romanit "Kështjella" janë diagramet pozicionale të përballimit të blloqeve të përfshira në luftë. Përderisa diagrami pasqyrues i gjendjes së kështjellës dhe mbrojtësve të saj, gjatë tërë strukturës mban pozicionin e një horizontaleje gjatë tërë zhvillimit, diagrami i pasqyrimit në kampin turk i ngjan funksionit linear të drejtëzës që bie.

Personazhet, në varësi të karaktereve të projektuara, reflektojnë shumë kompetetivisht, dhe ky reflektim ka bazë shumë të qëndrueshme sociale e psikologjike. Spikat sidomos personazhi i kryeveqilharxhit, një ushtaraku që vepron në vijat përmbajtëse të sulmit (në taborin për furnizim me paisje dhe ushqime). Pothuajse në vijë të njëjtë kualitative e kompetitive, vazhdon të reflektojë edhe personazhi i kronikanit, por me një refleksion jo aq intensiv sa kryeveqilharxhi. Të vënë bashkërisht në lëvizje e në dialog, ky dysh personazhesh, në njëfarë mënyre bëhet baza më reflektuese e përjetimit të sulmit, dhe të humbjeve në sulm, në kampin rrethues turk. Tragjizmin e këtyre personazheve, në më të shumtën e rasteve, Kadareja e nxjerr në pah sidomos përmes dialogjeve mes tyre.

Kadareja, në romanin "Kështjella", ka bërë detyrën e misionarit në vijë të përjetësimit të luftërave të lavdishme, që populli shqiptar i ka zhvilluar kundër pushtuesve turq, me Skënderbeun në krye. Letërsia artistike, e sidomos narrativa letrare, duke qenë një fushë e volitshme për mbishpirtëzimin dhe mbipërjetësimin e jetës historike të një populli, shkrimtarit i shërben si një vegël farkëtuese për plotësimin e këtij misioni. Narrativa letrare, misione të këtilla ka kryer në vazhdimësi pothuajse në të gjitha këndet e botës, në periudha kohore nga më të ndryshmet, që nga antikiteti e deri në kohën e sotme.

PREÇ ZOGAJ - "IN LOVE", NJË MELODI POLIFONIKE

Nga Ali Aliu

Libri "In Love" i autorit Preç Zogaj është një libër poetik i veçantë për disa arsye. Ky vëllim sjell njëqind poezi të lidhura pas një boshti tematik, ku dashuria, është qendra. Në këto poezi ka mall e ngjyrim melankolik në prag elegjiak, ka afsh dhe zjarr emocional të gjallë, ka mëtim për ta pushtuar dhe për t'u pushtuar nga dashuria; ka distancë odeike të dashurive që lënë gjurmë. Në tërësi libri ka vargje të ngarkuar me një fluid ëndërrimtar, një prirje që bën bashkë të kaluarën me të tanishmen, pasionanten me të kërkuarën e të paarritshmen; dehjen për të dalë prej saj apo për të hyrë brenda saj…

Poezitë, që në fund kanë datën e zënies, shtrihen brenda harkut kohor të dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit XX dhe dy të atij XXI; të vendosura brenda shumicës së atyre pa data, me të cilat ato përplotësojnë veten dhe i përplotësojnë të tjerat; së bashku ruajnë prirjen e poemthit lirik; ato natyrshëm marrin në krahët e veta poezitë e tjera, që janë shumicë, duke i vënë në funksion komunikimi mes njëra-tjetrës duke e përfillur statusin e poemthit lirik; prandaj kudo që prek, që vë dorën dhe hap faqen e librit, cilado poezi që rastis, frymon brenda boshtit unik…



Komponimi i tillë i librit mbi dashurinë, i derdhur në kohë, bëmat dashurore rrjedhin doradorës me ndiesinë e pranisë së fijes që i ushqen dhe mban bashkë të gjitha perspektivat. Harku kohor i hapur ndaj dhe për dashuri, sa me kthjelltësi të plotë, sa ngjizur në gjysmëndërrime, sidomos gjatë prehjeve në krahët e mallit, zgjimit të kujtimeve.

Ai nuk e adhuron atë nga distanca platonike; ai e sjell, e gjallëron me prani afshi, e sjell mëtim zjarri dashuror; Preçi nuk i këndon ode bukurisë së detit nga larg pra, ai është brenda, valëve të kaltra, thellësive; është pasuri shpirtërore për të dashuruar, për të qenë i dashuruar nga të gjitha ngasjet, pse është kuptim, kuptimësi ekzistence.

Ka brenda vargut edhe vetmi dramatike, ka revoltë përballë thatësisë së shpirtit, përreth e kudo, thirrje përgjërimtare, për dashurinë - kuptim i parë, ekzistencë, (sado të gjithë ikin nga ajo, apo ikën ajo nga të gjithë). Poezia e Zogajt është mëtim drejt gjetje - mosgjetjes së dashurisë, një kërkim pa fund, ngjashëm me dy të rinjtë e dashuruar tek romani i Orhan Pamukut, "Jetë e Re" (Jeni zaman) në kërkim të njëri-tjetrit, edhe duke u shkëmbyer aq pranë drejtime të kundërta, për askund e për të mos u gjetur kurrë; ose që përballen sy më sy tek Preçi dhe në çast përftojnë pa e arritur të tërën, të përsosurën që nuk ekziston; njësoj si tek poezia antologjike e Fatos Arapit "Si s'të desha pak më shumë".

Pra dëshira për ta pushtuar të plotën, të tërën, dhe që duhet aq pak, por që s'arrihet kurrë, që s'i ka shkuar kujt përdore, që të ndërmend komentin e Niçes për Don Zhuanin,

(Vijon në faqen 11)

MISTERI SE SI U DËRGOVA NË PRAGË PËR OPERATOR FILMI

Nga Piro Milkani

Shtatori i vitit 1954 ishte fillimi i vitit tim të maturës në gjimnazin Raqi Qirinxhi (në godinën e ish Liceut francez të Korcës), i hapur në mesin e Luftës së Parë Botërore. Në ditët e para të shkollës erdhi për vizitë ministri i ri arsimit, tridhjetëvjecari Ramiz Alia (ishte emëruar menjëherë pas dëbimit përfundimtar të Bedri Spahiut dhe Tuk Jakovës, nga kupola më e lartë e Partisë së Punës për "veprimtari armiqësore").

Ministri Alia zgjodhi atë mëngjes klasën tonë, të katërtën A, për të bërë një bisedë të shpenguar me 26 maturantët e klasës sonë. Ndër të tjera na porositi te mesojme fort se vitin qe vjen do të ketë më shumë bursa studimi për jashtë shtetit. Po atë dite na ftoi për një ndeshje voleibolli. Në ekipin e tij ishin drejtuesit e organizatës së rinisë te qytetit me në krye Pandi Allabashin, në anën tjetër të rrjetës ne maturantet e të katrës A. Ishin më të fortë e na mundën që në të dy setet e para.

Për mua, atë vit ngjarjet më të rëndësishme ishin letrat shumëfaqëshe që Viktor Gjika, shoku im i fëmijërisë, më dërgonte nga Moska. Më tregonte në to jetën e magjishme që po kalonte në Institutin e Lartë të Kinematografisë –VGIK- ku po studionte fillimisht për regjisor të filmave dokumentarë shkencorë e më pas se si kaloi në katedrën e degës së kamerës (drejtor fotografie). Letra mbyllej gjithmonë me frazën: Ke të fala edhe nga Taqoja (e kishte fjalën për djaloshin vlonjat, Dhimitër Anagnostin).

Deri në mars të vitit 1955 ato letra ma kishin bërë mendjen çorap, kur drejtori i gjimnazit, Dhori Belba, më thiri në zyrën e tij për të plotësuar formularin e famshëm. Pas pyetjeve rutinë, emri, mbiemri, atësia, profesioni i babait dhe i nënës, datëlindja etj., erdhi paragrafi më i rëndësishëm:

- Çfarë dëshiron të studiosh në shkollën e lartë?

- Inxhinieri për përpunimin e lëkurës - i thashë.

E kishim në Korcë një fabrikë të tillë, që përhapte gjithandej një erë të ndyrë, po sidoqoftë unë do mund të isha inxhinier i saj.

- Tjetër?-pyeti pa e ngritur kokën

- Inxhinier hidroelektrik!

Po ngrihej një hidrocentral në lumin Mat, por flitej se do ngriheshin dhe te tjerë.

- Po tjetër?

Pra bëhej fjalë për tri dëshira. Si në përrallat me mbret. Thuaj tri dëshira dhe unë do t'i plotësoj, i thoshte mbreti fukarait që i shpëtoi jetën vajzës së tij.... Heshtje.... Ta them, mos ta them? Po sikur të zemerohet? Të dalë ku të dalë. Po e them:

- Kinematografi!!!

E ngriti kokën dhe më pa me sy zhbirues e buzëqeshi paksa me ironi (sigurisht me zë të brendshëm do ketë shqiptuar: Spurdhjak...U bëre dhe ti!)

Po deshi s'deshi, e shkroi në formular.

E pashë tek shkruante deri te rrokjet e fundit.... g r a f i.

- Lajmëro tjetrin, - më tha gjysmë i zemëruar.

Nuk kaloi shumë dhe filloi sezoni i provimeve të maturës. Më përjashtim të Gjergji Angonit, të cilit ia kishin pushkatuar babain në vitin 1945, apo të Rexhep Bregut, nxënësit më të mirë të klasës sonë gjatë katër viteve të gjimnazit, për shkak se në fshat familjen e tij e kishin shpallur si familje kulakësh, apo të Jani Avramit, që ishte anëtar i partisë komuniste por e kishte babanë emigrant ekonomik, të ikur në Amerikë para luftës, të tjerët mësonin dhe ëndërronin për një bursë jashtë shtetit. Diskutimet bëheshin a ishte më mirë të shkoje në Bashkimin Sovjetik apo në Çekosllovaki se vendin e fundit në preferencë e zinte Bullgaria. A nuk e tha vete Ramiz Alia se këtë vit do ketë shume bursa studimi?

Provimi i parë, matematika me shkrim. Kush e mbaronte detyrën dorëzonte fletën dhe dilte jashtë klasës. Pandi Pepivani dhe unë e dorëzuam fletën të parët. Jashtë verifikuam rezultatet e ekuacioneve dhe kur ato na u puqën u bindëm se kishim bërë zgjidhjen e duhur për një notë maksimale. Po ishte ora dhjetë e mëngjesit. Ç'të bënin tani? Të shkonim në shtëpi? Vendosëm t'i ngjitemi malit të Moravës deri në majë. Të rinj ishim dhe nuk dinim se ku t'i harxhonim energjitë. Po t'i shpejtonim hapat gjatë të përpjetave e shumta një orë e gjysmë, po ja dhe dy orë do të mbërinim në majë të "Everestit" të qytetit tonë. Dhe ashtu u bë. E si mund të kishim lodhje? Provimi shkoi në rregull e unë nuk i kisha as shtatëmbëdhjetë vjet. Pandi disa muaj më i madh.

Duke u thekur në diellin që nuk të digjte si aty poshtë në Korcë, hodha sytë te një gur i rrumbullaktë pak më i madh se një top pingpongu. Poshtë tij ishin fshehur dy zhuzhakë të vegjël që drita e diellit ua bënte më të fortë ngjyrën e tyre jeshile të errët. I mora dhe i mbështolla me një copë letre që m'u ndodh në xhep. Kur u ktheva ne shtëpi e nxora letren dhe doja t'ia jepja vëllai tim të vogël, Vaskës. Për çudi gjeta vetëm një zhuzhak. I dyti nuk gjendej. Do jetë arratisur, i thashë Vaskës.

Të nesërmen shkova në bibliotekën e qytetit që të përgatitesha për provimin e matematikës me gojë. Qëndrova aq gjatë deri sa rrezet e diellit me erdhën nga pas shpinës. Qetësi e admirueshme, e përshtateshme për përqendrim maksimal. Befas një cërr cërr e fortë theu heshtjen. Të pranishmit ngritën kokat. Ç'është kjo? As unë se kuptova se nga vinte. Po cërr cërri i dyte ishte dhe më i fortë. Vinte nga poshtë vatave të xhaketës time. Nxehtësia e rrezeve te diellit e kishte zgjuar nga përgjumja zhuzhakun tim. E godita supin tim të majtë dhe zhuzhaku pushoi. Futa dorën ne xhepin e majtë dhe zbulova një shqepje të vogël te astarit. Ja ç'na paska qenë. Ishte arratisur nga brima e astarit. Ndërprva studimin dhe u largova nga salla.

Provimet i mbarova të gjitha me notat maksimale. Njëlloj si Viktori një vit më parë që rrembeu një medalje ari. Sa medalje te tjera do të merte në gjysmë shekulli punë në Kinostudio Viktori. Po ajo gjithmonë do të ishte e para.

Nuk mbaj mend se si e mora vesh se më kishte dalë bursa e studimit për jashtë, po gëzimi ishte i pamasë. Pas disa ditësh do të niseshim te gjithë në Tiranë për një seminar. Nga 52 maturantët më shumë se 20 prej nesh na kishte buzeqeshur fati. Do studionin jashtë shtetit. Ishte e dyta herë që shkoja në Tiranë, që në krahasim me Korçën me dukej si një metropol i vertetë. Lektorë të ndryshem na sqaronin për situatën politike, se si duhet te silleshim që të mos turpëronim Shqipërinë etj., etj. por asnjë fjalë se ku dhe çfarë do të studionim.

- Kthehuni dhe pas disa ditësh merrni në telefon ministrinë e arsimit.

Ishin ditët më të gjata të pritjes. Gëzim dhe "ankth". Pas pesë ditësh, u bëmë katër a pesë dhe shkuam në Postën e qytetit. Askush nga ne, veç disa funksionarëve të zyrave të shtetit e partisë, të policisë, ushtrisë apo disa mjekëve të qytetit, nuk kishte telefon në shtëpi. Në kabinë hyri Qirjakoja kur centralistja e lidhi me zyrën e sekretarit të ministrit. Po, po e kishin vendosur se ku do shkonim. Pyeti së pari për vehten e tij. Inxhinier transporti në Çekosllovaki. Pastaj me radhë: Servet Pëllumbi në Moskë për filozofi, Zhaneta Kotmilo dhe Agron Kallamata (i vetmi egjiptian në maturën tonë) në Hungari. Zhaneta për farmaci, Agroni për mjekësi. Asim Ylli në Gjermaninë Lindore, për mjekësi. Servet Backa, në shkollën e sigurimit në Moskë. Pyeti dhe për mua. Në Çekosllovaki, për operator filmi!

O Zot! C'më bëre kështu? Ma plotësove dëshirën time. Atë të tretën. Për atë që drejtori më buzëqeshi me ironi kur i thashë se dua të mësoj për kinematografi. Njëlloj si Viktori. Veçse ai në Moskë e unë në Pragë. Nuk qëndrova dot të mësoja se ku do shkonin të tjerët. Po nxitoja si i marrë drejt shtëpisë për t'u dhënë lajmin prindërve dhe vëllezërve të mi. Po ishte e pamundur. Nxitimin ma ndërprenë, tamam para monumentit të Luftëtarit Kombëtar (apo Ushtarit të panjohur, si e thërisnim ne) dy mësueset e mia, Dhimitra Gjini apo Maliqarka, mësuese e letersise

dhe Arsinoi Bino.

- Hë mo Piro, për ku të doli bursa?- pyeti plot kureshtje Maliqarka (nuk ka njeri ne Korcë që mos ta ketë një nofkë)

- Për Çekosllovaki! Do studjoj për operator.

- Uaaa!!! Sa mirë! Dëgjo këtu, Arsinoi. Mos e bëj apandisitin pa u kthyer Pirua. Dhe vazhduan rrugën. Nuk kisha kohe t'i sqaroja për gabimin e tyre. Më duhej të shkoja në shtëpi. Asokohe në Korcë operator quheshin mjekët kirurgë. U largova pa i sqaruar si duhet. Sigurisht më vonë e morën vesh "gabimin"

Pas disa ditësh, përsëri në Tirane. Mbledhjet e fundit para nisjes. Po si ndodhi në të vërtetë kjo mrekulli e Zotit?

Në pranverën e vitit 1955, Ministrisë së Arsimit i kishte ardhur një përgjigje pozitive nga Çekosllovakia, për kërkesën që kishin bërë për dy bursa studimi për operator filmi. Ministria kishte njoftuar Kinostudion. Viktor Stratobërdha, ishte ylli në shkëlqim i regjisorit që u diplomua në Moskë si asistent i profesorit të tij Sergej Jutkeviç me filmin Skenderbeu. Kush më mirë se ai do vendoste për këtë ofertë. Shkoi direkt e në Liceun Artistik të Tiranës dhe u takua me maturantët e degës së Arteve Figurative. Piktorët e skulptorët e ardhshëm. Më mirë se ata me prirje figurative askush nuk mund ta bënte këtë profesion. I pyeti direkt:

- Kush nga ju ka dëshirë të studjojë në Çekosllovaki për operator filmi?

I pari që ngriti dorën ishte Saim Kokona. Po diplomohej për piktor. Ia mbajti shënim emrin. Me përtesë e ngriti dorën një i dytë. Ishte studenti i degës së skulpturës Mit'hat Fagu. E shënoi dhe emrin e tij. Asnjë nga të pranishmit nuk e ngriti më dorën. Endërronin të bëheshin a piktorë, si profesor Buza a skulptorë si profesor Paskali.

Viktori i kënaqur se gjeti dy emra te përshtatshëm shkoi i çoi në Ministri.

Disa javë më vonë, Mit'hati, i penduar shkoi në Ministri dhe kërkoi t'ia hiqnin emrin.

- Po të ishte për Moske hajde de, po për Çekosllovaki as mos t'u shkojë në mendje. Bile në Moskë doja të shkoja të studioja për regjisor, po jo operator, u kishte thënë Mit'hati.

Po kjo pikë e zezë, thanë ata në Ministri. E kemi një bursë dhe biri i botës e refuzon. Ç'të bëjmë? I shkuan nëpër duar edhe një herë të katërqind e ca formularët e gjithë maturantëve të Shqipërisë dhe: EUREKA! E gjetën. Njëfarë Piro Milkani nga Korca paska kërkuar të studiojë për kinematografi. Më i vogli në moshë, nuk i ka mbushur akoma shtatëmbëdhjetë vjet po notat i paska të gjitha pesa. U bëftë më e mira. Lë të shkojë Pirua në vend të Mit'hatit. Këtë mister e mësova në Pragë nga Saimi, që u bë shoku im më i mirë. Nip i Kallfëve, fotografët e njohur të Studios Kallfa në Tiranë, e kishin mësuar Saimin të fotografonte por veçanërisht të retushonte fotografitë që klientët të dilnin më të bukur se sa ishin në jetë. Ai më mësoi abc-në e parë të fotografisë para profesorëve të mi çekë. Mbas maturës Mit'hati shkoi të kryente shërbimin e detyruar ushtarak. Unë në Pragë, ai ushtar. Pasi u lirua në 1959, e dërguan në Moskë për të studiuar regji filmi. Aty ku kishte dëshiruar. Mik të fortë duhej të kishte pasur. Veçse as miku e as Mit'hati vetë nuk mund ta parashikonin se në vitin 1961, mijëra studentë shqiptarë do ktheheshin me pushime por nuk do riktheheshin më në Europën Lindore. Kish filluar një "miqësi e re". Ajo me Kinën e Mao Ce Dunit.

(Vijon nga faqja 9)

simbol i kërkimit të mrekullisë lumturore që prore pasohet me zhgënjimin e radhës; për të rinisur nga e para dhe për të mos arritur; ngjashëm me pasionin flakë të filozofit që nuk mjaftohet pas asnjë objektivi të pushtuar, që s'është më lumturori, më i përsosuri e që s'e ka pushtuar kush… (në një poezi Niçe thotë: "Jam flakë, i huaj për prehje, Djeg duke u djegur dhe vetë".)

Preçi s'djeg, as digjet. Ai kërkon, gjen dhe rigjen prehje lumturore në gjirin e dashurisë, dashurisë së përmasave njerëzore; në përballje sfidash, zhgënjimesh të ngushëllueshme dhe të pangushëllueshme, me besimin se mrekullia qëndron pranë, aty rrotull dhe rreth nesh.

Autori i librit 'In Love' i ofron lexuesit studion e vet të hapur, ia ofron sfidat lumturore dhe vuajtëse të dashurisë; ato vijnë valë nga më shumë anë, gjendje, situata çasti dhe së bashku lidhin, kuptimësojnë një shtrat, rrjedha si nisje dhe rinisje dashurore, nga e para, në nxehje apo vakje, gjithë frymëzim, oksigjen pa të cilin nuk ka kuptim asgjë.

Vargjet rrjedhin valë-valë si melodi polifonike, kreacione të natyrshme, qëndrim konstant i tavanit artistik.

Autori vë përpara albumin e dashurive, jepet krahëve dehëse në arrati me pasionin e fjetur e të zgjuar dashuror; gjurmëve stampuara në memorie, fluturimeve të veta, përftimeve, dashurinë e tanishme dhe të përhershme; jehona e valëve dashurore me këtë rast vjen Orfe që fton tërë universin të përfshihet në melodinë e tij, në fluturimet lumturore që magjishëm zhduk kufij, këtej dhe përtej, ai që dashurinë, të dashurën e ka bashkudhëtare të përjetshme…; në çaste vetmie, mbase larg zhurmërisë, shfaqet përpara, e gjallë fytyra, kurmi dikur i dashuruar, gjendje, zëra, klithma lumturore dhe çdo gjë përreth merr pjesë; bie në një përgjumjeje dehëse, ndjellëse; strehë kjo që bën bashkë, të rigjeturën, të gjeturën; abstragon çdo gjë grishëse përreth brenda strehës shndërruar tani si univers dashurie i zërit, i të adhuruarës, deri në gjetjen e rigjetjen e radhës, deri në faqen e fundit të librit…

Dashuria mes gruas dhe burrit është më shumë se një pëlqim, është përtej një tërheqje çasti; më shumë se edhe një çast lumturor; është tërheqje drejt një përsosjeje lumturore, mëtim drejt përjetshmërisë, majë e arritshme dhe e paaritshme që njerëzimi s'do të resht kurrë së synuari…

Malli është dhembje shpirti; për dashurinë e gruas dhe burrit, nga më të mëdhenjtë. Grekët e lashtë, për ta qetësuar e lehtësuar atë, mallin, shpikën barin, lëngun çudibërës Nepentes. Por malli është edhe dëshmi e shpirtit të begatë, që e ushqen, e mban gjallë dashurinë. Në çaste vetmie sidomos, ai gjallëron bëma lumturore, të largëta dhe të afërta, shpërfaq personin më të dashur, të adhuruar, mbush boshësinë përreth me bukuritë e saj/të tij, me hiret fizike dhe shpirtërore, aromën, magjinë e syve, derdhjen ar të flokëve, i himnizon ato dhe i anullon distancat, të gjitha në pritje, alarmuar dhe s'ka si të mos vijë ajo, si tek vargjet e poezisë 'In Love', kur ia beh si shkrepje e beftë drite, përmasa qiellore, duke lënë pa frymë hapësirën; duke u zhbërë çdo gjë përreth, në çast shfaqet ajo, lartësive të Safos (Sa më vështroi mbetem pa zë dhe gjuha më ngrin…) dhe trupi im që dridhet si kodër, si gjeth, si kitarë; mrekullia edhe më lumturore, më qiellore me që vjen në një thatësi shpirti, kur gjithçka përreth vrapon më shpejt se dashuria, kur, gjithçka kërkon të dalë nga dashuri.

Lirikat dashurore në librin e Preçit, shpërfaqin prirjen e krijimit të një strehe, ku dashuria do të jetë e mbrojtur nga brutaliteti, vulgariteti dhe agresiviteti, strehë përzgjedhur me delikatesë dhe elegancë fisnike, përmasash të vetë dashurisë, strehë me status sipëror, ku përftojnë nuanca me finesa perfekte, timbresh himnike, baladike, nostalgjike që derdhen përplotësuese mesveti, dhe që e rrëmbejnë, në valet e veta lexuesin, sidomos atë me prirje onirike, prirje që dorëzohet ngasjeve associative, ëndërrore të lirikës.

Libri më i ri i Zogajt, rreh në frymën nerudiane; edhe për këtë, ai nxit hamendësitë e shpeshta në hapësirën shqiptare, për deficitin e këtij zhanri të lirikës; në harkun kohor socrealist shqiptar, edhe dashuria në art, do t'u përmbahej dozave të pëlqyera, ndërsa në atë kosovare, përparësi kishte refleksi refuzues, rezistues ndaj pushtuesit; libri 'In Love' me prurjen, hapësirën, me njëqind poezitë frymëzuar nga dashuria, nga perspektiva e zërit të dashuruar, sikur mëton të konpensojë, të mbushë boshllëqet që ka lirika e dashurisë në letërsi.



Pyetësori "Librat e jetës sime"

ROLAND GJOZA

Libri që do të doja të kisha shkruar? "Bukuroshet e fjetura" të Kavabatës.

1) LIBRI QË PO LEXOJ NDËRKOHË

Letërsia e madhe është një intimitet i tradhtuar, një e fshehtë e rrezikshme e zënë në befasi. Një imoralitet, një aestetikë e dënuar me mohim. Rëndom librat e mëdhenj si "Zonja Bovari", "Një tragjedi amerikane" apo "Motra Keri" kanë cenuar ligjet e moralit dhe të estetikës.

Unë qaja natën. Isha trembëdhjetë vjeç dhe qëndroja te vitrina e librarive për një kohë të gjatë. Atje bleva librin e parë "Plaku dhe deti" të Heminguejit, nuk e kuptova, por ama e quajta një libër të madh. Ishte intuita që më ndillte drejt librave të tillë. Edhe sot nuk e kuptoj pse ndodhte kjo, kur në vitrinë ishin dhe librat e Zhyl Vernit. Qaja natën dhe prisja të zgjohej nëna për t'më qetësuar. Sa herë që ata vallëzonin gjer vonë në lulishtet e verës, vinte Agllaia, një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçare për të më bërë shoqëri. Ajo më lexonte tregime të Mopasanit. Unë fillova të kuptoj se isha mashkull dhe mund ta shikoja Agllainë me një sy tjetër. Dhe tani që po shkruaj këto radhë unë po rilexoj tregime të zgjedhura të Mopasanit në anglisht dhe përfytyroj netët me Agllainë, ato prekje si padashur të saj. Të nesërmen dilja në rrugicë dhe iu lexoja shokëve skenat me seks.

I jam kthyer rileximeve dhe kohën më të madhe ua kushtoj klasikëve. Përherë e më tepër kam një tërheqje të çuditshme ndaj tyre, sikur hyj në një katedrale dhe iu afrohem ikonave.

Letërsia e sotme është e mbushur me bestseller, ajo me kohë ka hyrë në zonën e rrezikshme të biznesit. Tundimi i parasë po prish fjalën si një virus. Prandaj është çoroditur dhe Nobeli, se letërsia nuk ofron aq shumë talente si dikur. Merr një roman dhe lexon një ese, ose një konglomerat dijesh: filozofi, psikologji, sociologji... Romani i mirëfilltë është bërë rob i eksperimentimeve. Denduria shkrimore dhe rrallësia e talenteve të mëdhenj është kthyer në një sëmundje të kohës.

Ah, Agllai, që s'vjen më!

2) LIBRI QË MË NDRYSHOI JETËN

Kadare, pa dyshim. I tjetërllojtë, një antirevolucion brenda revolucionit, një rrezik i pranuar. Gjithmonë më është dukur një privilegj që Shqipëria kishte një shkrimtar aq të madh. "Përbindëshi" u lexua në grup, në kodrat e liqenit. Na dukej çudi sesi mund të shkruhej një roman i atillë. Ishte njëlloj si në një dasmë fshatare të vinte dhe të këndonte Bitëlls. Letërsia shqipe e asaj kohe ishte e palexueshme. Përveç Kadaresë dhe Migjenit të madh, që sa herë e lexoj, më duket se nuk e kam lexuar. Më vjen çudi sesi ai po lihet në heshtje, shqiptohet si i madh, po nuk po shkruhet më për të. Pyeta një ditë një botues kosovar se ç'mendim kishte për Migjenin dhe ai, për çudinë time, heshti. Edhe për Kadarenë klani dhe ushtria e karkalecëve ia kanë hyrë me kohë tradhtive të vogla. Po nuk kanë ç't'i bëjnë, veç ia shtojnë helmin vetes.

Nga letërsia botërore Drajzer dhe Balzak. "Gjeniu" dhe "Motra Keri", "Xheni Gerhard", të lexuara në origjinal. Dhe të rilexuara për të tretën a të katërtën herë. Nga Balzaku "Xha Gorio", "Kryevepra e panjohur", "Mesha e ateistit", "Iluzionet e humbura", "Lëkura e Shagrenit". "Të mjerët" e Hygoit, "Saga e Fortsajtëve" e Gollsuorthit, "Lufta dhe Paqja" dhe "Ana Karenina" të Tolstoit, "Vëllezërit Karamazov", "Idioti", "Krim e ndëshkim" nga Dostojevski, të gjithë romanet e Turgenjevit, gjithë tregimet e Çehovit, të Mopasanit, Pirandelos etj. Dhe kështu listës do t'i shtonim dhe autorë të tjerë të mëdhenj që e bënë jetën time të shpëtonte gjysmën e saj socialiste pikërisht nga libri...

3) LIBRI QË DO TË DOJA TË KISHA SHKRUAR

"Bukuroshet e fjetura" të Kavabatës. Isha në Amerikë kur e lexova, poshtë në metro duke shkuar në punë dhe zbrita atje ku isha nisur. Pra, e kisha humbur ditën e punës. A mund të shkruhet një roman i tillë, mendova me entuziazmin e një dashnori që sapo ka marrë një "po" të papritur nga një "bukuroshe e vështirë". Nuk e dija që me mjetet e një filigranisti mund të shkruhej një roman i atillë, që ngjante me avujt e trëndafilta të lotuseve aziatikë kur zbardh agimi, apo me ajrin që fsheh pandehmat tona më ambicioze, por që i mban të fshehura. Shumë shkrimtarë janë tunduar nga ky roman fare i vogël sa një flakon parfumi, madje edhe Markezi i madh, që ka shkruar një roman i ndikuar prej tij.

Tundimet janë të mëdha sepse kryeveprat e shkrimtarëve të mëdhenj, në njëfarë mënyre, krejt iluzore, bëhen të tuat, përderisa libri është yti dhe ti ke fatin ta lexosh dhe në një çast marrëzie të bukur të duket se je ti ai që e ke shkruar. Dhe ta besosh dhe të zhgënjehesh prej këtij besimi donkishotesk, dhe të falesh për hir të asaj se ti je adhuruesi i madh dhe kujt shkrimtari nuk i pëlqen kjo? Sikur t'i thoshe Çehovit: Ah, ta kisha shkruar unë "Zonja me kone", ai do të buzëqeshte pas lenteve të lornjetit me atë buzagazin e tij të hollë si prej një vezullimi të beftë të unazës me diamante të një zonje të bukur. Dhe ironia s'do t'i ndahej, padyshim.

Dhe do të trishtohej si për veten po t'i përmendje "Pavijoni 6" sepse ai me kohë ishte brenda atij pavijoni të çmendurish për t'i shpëtuar realitetit. Pastaj një tik nervor, një trembje e beftë dhe një lutje "Mos o Zot!" po t'i përmendje "Murgu i zi".

Një kënaqësi e fshehur, po dhimbshëm e parealizueshme, një ah, që më shoqëron sa herë e kujtoj. "I huaji" i Kamysë. Koha jonë: irracionalizmi dhe absurdi i saj. Marrëdhëniet e prishura njerëzore në një roman prej 80-90 faqesh. Sa shkurt! Po sa i pafund mendimi sepse universaliteti nuk dashka shumë faqe, po shumë mendime në pak tekst.

O Zot, mos më lërë të zgjatem më!

4) LIBRI QË PATI NDIKIMIN MË TË MADH NË SHKRIMET E MIA

"Fije bari" i Uollt Uitmanit. Ishin vitet gjashtëdhjetë dhe lexonim "Shekulli im" të Kadaresë. E kishim gjetur Eldoradon tonë.

Në një tryezë dëgjoj dikë që vinte nga jashtë: Po s'lexove Uitmanin nuk bëhesh poet. E kërkova dhe më në fund e gjeta. "...s'bëhesh poet!" më vinin fjalët e tij. Po unë e kisha gjetur njëherë Eldoradon: Kadareja! U ngjita te Kodrat e liqenit, dy hapa nga shtëpia dhe nisa të lexoj: Ç'është ky libër? Poezi është kjo? Po unë isha kokëmushkë në ato kohë, më pëlqente pa masë të shkoja kundër rrymës. Lexo e lexo pa qejf dhe për t'u ngushëlluar i kthehesha Eseninit: Rusia Sovjetike "I huaj ndjehem në vendin tim." Ky varg e kishte ruajtur një kambanë prej kishave ruse dhe binte brenda shpirtit tim. E lashë për një kohë Uitmanin, por po ndodhte çudia, ai filloi të ndikonte në poezinë time, e lashë vargun me rimë dhe iu ktheva vargut të gjatë, gati prozë, të Uitmanit. Ndoshta prej tij fillon dashuria ime e madhe për Migjenin, se dhe ai shkruante me varg të lirë. I thosha vetes: sa prapa paskam qenë! Dhe kështu u bëra ithtar i zjarrtë i Uollt Uitmanit, i librit të tij të jashtëzakonshëm "Fije bari", i përkthyer mjeshtërisht nga Skënder Luarasi. Ai mbeti dhjata ime në poezi. Ndërsa në prozë dy janë ata që kanë ndikim të përhershëm tek unë: Mopasani dhe Çehovi.

5) LIBRI QË MË KA NDRYSHUAR MENDJEN

Shekspirin më shumë e kam ndjekur nëpërmjet filmave "Makbeth", "Hamlet", "Mbreti Lir", "Otello". 14 vjeç kam lexuar *Makbethin* dhe *Hamletin.* Pa i kuptuar gjer në fund, ose pa i kuptuar gjithsesi, po ama, shumë gjëra i mbaj mend edhe sot.

Shekspirin e kam lexuar me hope. Jo me dalldinë e një dashnori të zjarrtë, po të një studenti të zellshëm që do t'i hyjë detit në këmbë. Dhe asnjëherë nuk e kupton gjer në fund dhe jam i lumtur që e rilexoj dhe gjer në vdekje do të mbeten shumë zona të paeksploruara prej meje. Përse ndodh kjo? Në këtë mes nuk ka një arsye që t'i gjesh një përgjigje të mundshme. Ndoshta gjenialiteti fsheh shumë gjëra që as ai vetë s'i di. Pastaj çdo moshë ka një shkallë të re njohurie. Ndonëse edhe kjo s'të ndihmon dhe aq në njohjen e plotë të Shekspirit. Pyeta një ditë Timo Fllokon, që e di përmendësh dhe e reciton anglisht në shtëpi, mes miqsh, kudo që të ndodhet: "mund të lexohet Shekspiri gjithë jetën? I vetmi që mund të lexohet gjithë jetën, ai më ndryshoi, ai më bëri ky që jam, kaq sa jam!"

Ja, libri të ndryshon!

Po në kohën e teknologjisë, të mjeteve të shumta të informimit? Ai rrezikohet! Sa herë vij në Shqipëri shoh si ngrihen gratacielë dhe më duket sikur çaj nëpër male betoni. Asnjë park midis morisë së pallateve ngjitur me njëri-tjetrin, asnjë bibliotekë, po vetëm beton dhe celularë, celularë ku grinden e shahen dhe dashurohen. Po libri?

Rrallë shikoj njeri me libër.

Koha e ngrohjes globale dhe e ftohtësisë së librit! Koha e fast-food-it! Dhe shpesh kthej kokën përskaj ose mbyll sytë se libri shitet në rrugë, në trotuar.

Dhe Shekspiri!

6) LIBRI I FUNDIT QË MË KA BËRË TË QAJ

Ana Karenina kur hidhet në rrotat e trenit. Cila qe tragjedia e saj? Zemra s'njeh arsye. Zhan Valzhani në fund të romanit "Të mjerët" i braktisur nga të gjithë. Roberta që mbytet nga Klajd Grific në romanin "Një tragjedi amerikane" të Teodor Drajzerit. Esteri e braktisur nga i dashuri që mbytet

në fund të novelës "Lulet e mollës" të Xhon Gollsuorthit. Fundi i Xha Gorioit i braktisur nga vajzat, kur ai s'ka më verdhushka për t'iu dhënë.

Është koha ime e rileximeve, koha e artë. Dhe në ato kryevepra ka shumë skena kur sytë mbushen me lot. "Vdekja e Ivan Iliçit" të Tolstoit... A nuk të duket se qajmë për veten tonë?

7) LIBRI I FUNDIT QË MË KA BËRË TË QESH

Nga "Aventurat e Ulenshpigelit dhe Lame Gudzakut" të Sharl de Kosterit kam kaluar te "Goja e kalit" e Xhojs Kerit, nga "Ushtari i mirë Shvejk" i Hashekut, te Rableja me "Gargantua e Pantagryelin" e tij të pavdekshëm.

Ishte një izolim i detyruar nga koronavirusi dhe doja të qeshja. Ishte një kërkesë e brendshme imja, e papërballueshme. Edhe kur komunikoja me miqtë, në internet, doja t'u ngjisja edhe atyre të qeshurën, në kontrast me lajmet e këqija, që vazhdojnë të na tronditin edhe sot. Nuk shikoja më tv, iu shmangesha lajmeve, sepse nuk i përballoja dot, kërkoja të qeshurën me ngulm. Gjersa m'u kthye në një ritual.

8) LIBRI QË MË VJEN TURP QË NUK E KAM LEXUAR ENDE

"Canto" e Ezra Paund". E porosita në *Amazon*. 1 dollar. Konsiderohet si *Iliada* moderne. Dhe të gjithë poetët amerikanë të çmimit *Pulitzer* (një pjesë të tyre i kam përkthyer). Gjithsesi provon ndjenjën e një disfate.

9) LIBRAT QË KAM DHURUAR

Së pari kam qenë hajdut i librave. Kjo ka nisur qysh herët kur në banjën e një shoku gjeta "Tragjedinë amerikane" dhe "Belami" që përdoreshin për letër higjienike. Një herë tjetër gjeta katër vëllimet e *Doni i qetë*. I zëvendësoja me libra të vjetër shkolle. Nga një banjë nisi formimi i bibliotekës sime të parë. Jepja shumë libra, një pjesë e tyre s'më kthehej më, dëshpërohesha po s'kisha ç'bëja. Kam dhuruar vetëm për ditëlindje. Kur erdha në Nju Jork gjeja libra në trenat e metrosë dhe në park. Njerëzit i lexonin dhe i braktisnin. Ishte një braktisje e qëllimshme: ai që ka parà e ble dhe e lë që ta lexojë ai që s'ka. Kështu që u mësova dhe unë të dhuroj libra, po me shumë dhimbje. Më duket sikur humb një mik. Po tani ka ardhur koha që të dhuroj gjithë bibliotekën.

10) LIBRI ME TË CILIN DUA TË MBAHEM MEND

Është një ves i shkrimtarit: i shuhet dashuria, ajo furi e zjarrtë e frymëzimit për librin që ka shkruar, pale ta lexojë përsëri. Nuk e di pse ndodh kjo! Adhuron gjer në çmenduri librin që do të shkruajë, por e mban të fshehtë, prej një ndjenje narciste të çuditshme. Me mend thotë: po shkruaj romanin më të mirë, po kur botohet ai është një roman i dështuar. Përgjithësisht shkrimtari gabohet me librin e tij, sepse ai është egoist, do që t'i ketë të gjithë librat të mirë.

Por në orët e gjykimit të kthjellët, që janë të rralla, ai është më fatkeqi. Është shpallur, është zhveshur lakuriq para lexuesit, është rrëfyer plotësisht. Kur i vijnë shenja të mira bëhet i padurueshëm, i shpëton në lumin e fjalëve vetëlëvdata, po kur nuk i vijnë shenja, telefonon mjekun psikiatër. Është shumë e vështirë të jesh shkrimtar po paradoksalisht bukur.

Dhe si përfundim unë s'jam në gjendje të them se me cilin libër dua të mbahem mend.

11) LEXIMET MË TË REHATSHME

Në metro. Në atë zallamahi ferri ku personazhet e librave vijnë dhe ikin përmes zhurmave të tmerrshme të trenave.

Pse? Nuk e di. Ndoshta më mbeti zakon prej vështirësisë kur shkoja dhe vija nga puna nëpër errësirën njujorkeze të nëntokës. Në qetësinë e parqeve nuk lexoj dot, në shtëpi as që mendohet, në bibliotekë, vetëm sa e sjell ndër mend, më kap mërzia. Po ku? Atje ku leximi i rehatshëm nuk ekziston, në metro kur shkoj dhe kthehem nga Manhattani.

12) LIBRI QË MENDOJ SE ËSHTË MË I NËNVLERËSUARI

Vetë libri. Dhe shkrimtari.

Tiranë, më 15 gusht 2021

PROZË E SHKURTËR



nga Nerinda Hysa

Andërrimtarë

...Asht bukur me ia ndi praninë , me e cik qoftë edhe lehtësisht ose padashje ... Me e pa asht paqe për shpirtin. Mendja, shpirti dhe trupi hedhin valle në këtë soditje ...

Atyre s'u duhet me folë që me u marrë vesht . Mjafton nji shikim edhe shkarazi apo me bisht të synit ose s'ka nevojë me u pa hiç! Ata kanë ndejtë vite pa u pa dhe janë kuptue. Me shpirt, përmes andrrash.

S'u lodhen t'u pritë. Plot vite. Pa numërim.

Me nji fill të hollë lidhej dashuria e tyne. Nji fill që askush se shihte por ia ndiente aromën. Njerëzit e nuhasnin, por s'e kuptonin ça ishte.

Gjithsesi kjo dashni asht barrë e randë për shpirtin .

Kajherë ikin vetëm mos me e ndi peshën. Por shndrit aq fort, ma tepër se nji monedhë e artë.

Ma fort se dielli.

Gabimtar

Ka aftësinë me thye gjithcka me atë shikim që ia hedh sipri objekteve si pluhun. Gjithçka e zhvok dhe e ban të duket e padallueshme, e shpifun.

Po të shihte ylberin, do të vrejtej dhe do të kapsallitte sytë , mandej do t'i kthente shpinën: - Asht thjesht nji bashkim i kotë ngjyrash, do të komentonte thatë.

Arti asht fëlliqësinë para syve të tij, qielli nji rreckë.

Fëmijët disa bubazhela që prodhojnë zhurmë , deti ujë me krypë ...

Ai, i merr gjanat ma të mrekullueshme të botës dhe i përplas përtokë, të pajeta, mbasi ua ka thithë shpirtin, që i mban gjallë.

Mendoja se kisha nji emën të veçantë, deri sa takova atë, më bani me dije se emni jem ka kenë i modës atëherë, i padallueshëm prej shumë të tjerëve, i njitrajtë. Ato kohë emna të tillë që mbarojnë padallim me këtë mbaresë –inda ,si Erinda, Nerinda, Nerejda dhe të tjerë janë si emna në seri.

Mbeta si e ngrime, qe nji tullë e hedhun turinjve ose thjesht prakticitet por unë parapëlqej ta quej mizori ose përplasje e realitetit me copa të mëdha .

E shoh si thahet gjithçka, si bien puplat e magjisë, si shprishen andrrat ... dhe më vjen me qa dhe qaj duke ndi se magjija ekziston mbrenda meje dhe kudo tjetër.Mjafton me hapë synin e mbrendshëm dhe me pa. Mjafton me zgju shpirtin dhe me e pa duke ju shkëput pak realitetit , duke guxu me hedh pak pluhun magjijet në krahë ...Magjija ekziston për ata që kanë sy me e pa dhe me e përfshi me vedin , në token e andërrt të jetës!

Ditë dimri ra mbi pezulin e dritares

I shof këto sy ... të thamë për miratim. Sytë e grues së plakun. E injoroj.

Por dikur ajo më flet dhe se kuptoj çfarë don prej mejet.

Më prek lehtë dhe shkon. Shkon për me vdekë diku tu e lëshu trupin butë rrazë luleve të kalbuna me nji erë të vrashtë

Ndonjiherë du me kenë e sjellshme e atëbotë rri në pritje . Pres...

I shqyej sytë dhe prirem kah ajo . E kqyri bukur dhe ndjej pëshpërimen e qiellit në mue .

Nji fllad i lehtë.

Nji puhi vdekjet.

Ndarja po vjen.

Po afrohet ngadalë dhe po na rrin si hije mbi krye .

Ftohtësia e nji mëngjezi zijosh , të pakufi në errnim .

Se di si do t'duket atëbotë kur të mos marrim ma frymë ... mundem veç ta imagjinoj , ndërkohë që rri në pritje .

Pres bukur dhe nuk ankohem nën dellin e ftohtë të dimrit , që s'din me ik.

Ditë e zakonshme vaji

E kam mendu shpesh; ata u bënë shkrumb e hi, në nji ditë të përvëluar në mes të verës.

Ishte nji ditë e bardhë, pa naze, nji ditë e qetë, si e ngathët ndoshta.

Ata u futën shpejt e shpejt në makinë. Mandej nji minute para, si nji lloj qetësie e tendosun, që mund ta prekje me dorë .

Rruga ishte e qetë, në fakt ishte si në nji paqe të patrazueme, nji ose dy makina .Mandej diçka ndodhi; fëmija ma i vogël filloi me ulëritë. Ata ndalen diku në nji cep. Nji vend me shkurre të lagështa dhe barishte të vocrra gjembaçe.

Dikush i thirri. Nji za i shplam (nga erdhi)

I thirri me emrat e secilit.

Mandej, kur banen me u nisë sërisht, makina shpërtheu . U tallazit ajria e plogësht e ditës. Flaka e purpurt, e vlueme që shkapëndante trupat e tyne të bamë shkrumb.

Pas dy apo tri orësh familjet kishin kuptu ç'kish ndodh . Mbledhje e përgjithshme. Anekand ulërima dhe të bërtituna. Njerëz që hidhen pupthi, vetëm ata kanë ngec aty brendë. Nuk do të lëvizin ma, nuk do të ikin ma s'andejmi.

Lanë nji si tym të vogël të rrëshqitshëm. Lanë shumë dhimbë dyersh e odash .

Pa ata jeta s'do të jetë e njejtë. Njerëzit i përkujtojnë, u çojnë lule. I thërrasin në emra. Qajnë për to .

GRUAJA ME QERPIKË TË GJELBËR

tregim nga

Ilir Levonja

Ndaj të ngrysur, në sheshin përpara shtëpisë së pushimit, në qafën e malit të Llogarasë, hyri furishëm një makinë e tipit "Aro" prodhim rumun, me targa qeveritare e ndjekur nga një minibus ushtarak. Ishte një vizitë e papritur, sa mend e vdiq fare përgjegjësin që atë kohë po shijonte një shishe vere të kuqe me mish thëllëze të pjekur në furrë së bashku me shefin e arsimit në verandën e dhomës së pritjes. Kur i pa makinat qeveritare poshtë ballkonit, u nxi i tëri dhe me gjysmë zëri iu lut tjetrit ta ndihmonte për të ngritur tavolinën.

- Shpejt Arsen, shpejt, - tha ai dhe, pa një pa dy, kapi cepat e mbulesës dhe i lidhi katërsh duke garrupuar ushqime, gota, shishe, lugë e pirunë dhe me një frymë i çoi në koshin e kuzhinës.

- Petrit, çfarë ka bërë vaki? - tha tjetri ndërsa e ndiqte nga pas. - Tërmet?

- Të keqen e tërmetit. Kataklizëm thuaj, prandaj mbathja poshtë në kaldajë te Lavdoshi.

Nga përjashta, zëri hokatar i një gruaje u dallua mbi të tjerët. Edhe pse frynte erë dhe kohë pas kohe kuiste ndonjë bretk, zëri i saj kumbonte. Gruaja nuk po bisedonte me njeri, ajo bënte ca "uaaaa" të tejzgjatura dhe kohë pas kohe përfundonte në përcaktime mbi natyrën: "Sa bukur, sa qejf, sa ajër i freskët!" duke rrëzëllyer disa të qeshura që i përpinte korija.

Pas gruas së re shkonte një alamet burri, i veshur me uniformë, por pa kapele në kokë. Kishte kaq shumë medalje e dekorata në kraharor, sa vezullimi tyre prej xhinglaminglash, të hutonte fare. Ai i mbante duart të lidhura pas dhe i rrinte gruas së re në një distancë prej disa metrash, madje as tentonte që ta zvogëlonte. Ndërkohë njerëzit e minibusit rrethuan vendin dhe më shumë se ministrin me gruan e re, shikonin korijen që po mbushej me mjegullën e të mugëtit. Komandanti i gardës i dha urdhër përgjegjësit, se qysh nga ai çast askush nuk duhej të hynte e të dilte nga vila, si dhe t'i dorëzonte urgjentisht listën emërore të punonjësve dhe gjithçka të bëhej gati për një gjysmë ore.

- Gati jemi, - ia ktheu Petriti, duke e pasur si fjalë të parë për efekt të protokollit.

Shtëpitë e pushimit bënin gati të njëjtin furnizim me një shtëpi ku jetohej përditë; për shkak të gatishmërisë, sa hahej e sa hidhej nuk kishte shumë rëndësi, mjaftonte të dokumentohej.

- Ashtu po, mirë atëherë, - tha ai dhe doli përjashta për të njoftuar ministrin.

Ministri erdhi pas pak dhe i kërkoi përgjegjësit të zbriste poshtë në kuzhinë bashkë me kamerieret, ku me sa u kuptua atij dhe gruas së re nuk ua kishte qejfi të shiheshin nga njerëzit e personelit. Megjithatë, më vonë u mor vesh meseleja - ajo nuk ishte gruaja, por e dashura, ndaj duhej të kishin shumë kujdes. Se qysh e tek doli llafi, nuk kishte rëndësi. Aty-këtu u krijua përshtypja sikur fjalët buronin nga misteri i holleve, ku një makth pluskonte me të ngrohtin e kaloriferëve. Sikur diçka e përmbishme çuçuriste vesh më vesh dhe njerëzit vetëm miratonin në heshtje.

- Të gjorat ne, - tha kuzhinierja. - Ku i mendojmë burrat dhe ku janë ata.

Përgjegjësi pa nga gruaja, por ajo dukej e sigurt në ato që thoshte. Kishte ndodhur që para disa muajve ata të dy kishin bërë dashuri, por ajo këtë nuk e llogariste. Burri i saj nuk ishte i gjorë, as gruaja e përgjegjësit. Ose ajo nuk e mendoi gjatë dhe më mirë kështu, pasi dukej si një lloj strategjie për të mbuluar flirtin.

Me kalimin e orëve gruaja e re u shpengua në lëvizje dhe gjysmë e ekzaltuar nga seksi, ajo shkoi deri aty sa zbriti vetë në kuzhinë. Kuzhinieret zbuluan një krijesë tmerrësisht të bukur, e cila kishte humbur brenda një robëdëshambri rozë me llushka plot parfum. Flokët i mbante mbledhur me rrjetë të tejdukshme najloni, duke lënë vetëm një balluke mbi ballë, që i mbulonte me dashje syrin e djathtë.

- Kam shumë uri! - tha ajo dhe mori me majë të gishtave një kokërr nespulle.

- Çfarë të hahet? - pyeti kuzhinierja dhe i hapi frigoriferin.

Gruaja e re u përqendrua të zgjidhte, ndërsa dy kamerieret e tjera u afruan dhe shikonin me habi qerpikët e saj.

- Dua vezë të fërguara me gjalpë, diçka si në shtëpi. Mundësisht t'i marr me vete në dhomë, pasi dhe bebi është i uritur, - tha ajo.

Kuzhinieret u panë ndër sy vetëtimthi. Një lloj habie i hutoi për disa sekonda sikur përpara syve t'u vërtitej një shkreptimë. Nuk duhej të hutoheshin dhe për më tepër të mos bënin pauza dyshuese gjatë bisedës.

Mariana vendosi tiganin e madh në vatrën e sobës dhe u bëri shenjë kamerieres që të bënin diçka. Ajo ndihej në siklet kur ato e shikonin mysafiren sikur të kishte ardhur nga ndonjë planet tjetër.

- Sa vezë të thyej? - e pyeti gruan e re me dëshirën për të ndërruar atmosferë.

- Katër kokrra, - ia ktheu gruaja. - Dy për mua dhe dy për beben.

Aroma e gjalpit mbushi dhomën dhe vezët në tigan zunë të frusronin. Mariana ia doli ta kthente situatën për së mbari.

- Vezët të ndihmojnë për të rënë nga pesha, - foli gruaja e re.

Mariana i buzëqeshi dhe pohoi me kokë për ta mbështetur, paçka se po e dëgjonte për herë të parë një gjë të tillë.

- Më beso, është dorë me një!

- Të besoj.

Ajo qeshi dhe sikur të ishte në kuzhinën e saj zuri e rrëmoi kanatet një e nga një, deri sa më në fund e gjeti atë që donte.

- E gjeta, - tha gjithë gëzim.

Qe një tabaka e madhe druri me një panoramë piktoreske të një bujtine fshati, përbri së cilës kulloste një dele me disa qengja. Tabakaja kishte dy këmbëza që i paloseshin nga poshtë, me një fjalë nga ato që përdoren për të ngrënë mëngjesin në krevat. Mirëpo si Marianës, kamerieres apo përgjegjësit, fakti që ajo kërkoi me ngulm atë, u shkaktoi një hije dyshimi sikur gruaja të kishte bujtur aty edhe më parë.

Ajo vendosi në tabaka pjatën me vezët e fërguara, pastaj kërkoi djathë deleje dhe dy copa buke të thekura, pa harruar edhe një shishe me ujë gline dhe dy gota qelqi.

- Po marr edhe ca nga këto të verdhat, - tha ajo.

- Nespulla, - e plotësoi Mariana, me mendimin se ajo nuk ua dinte emrin.

Gruaja mori tabakanë dhe për shkak se i kishte duart e zëna, e shtyu derën me kupën e gjurit duke zbuluar tulin e njomë të kofshës. Sado që e kishte mbështjellë mirë robëdëshambrin, përsëri iu zbulua një pjesë e mishtë. Mariana me kamerieret provuan sikletin e gruas, kurse përgjegjësi atë marrinë e mashkullit që i lëviz nervin.

Mariana iu afrua kamerieres, por kësaj here i humbi fjala. Për çfarë t'u fliste?! T'u thoshte mbyllni sytë!

Ndërkaq, gruaja e re kishte ikur dhe gratë u afruan te tavolina e kamerieres, pranë sportelit. Përgjegjësi mori një gotë dhe e mbushi me ujë.

- Ju e patë vetë që ata do të hanë në krevat, ndaj dhomën e ngrënies duhet ta kemi gati për në mëngjes, - tha ai.

Asnjëra nga gratë nuk ia vuri veshin.

- Qerpikë të gjelbër kurrë nuk kisha parë, - tha njëra nga kamerieret.

- Janë fals, nuk janë të vërtetë, - ia ktheu Mari-ana.

- E pra, se nuk ka mundësi.

- Të vetët kushedi se si i ka?

- Mund të mos ketë fare!

- Nuk besoj.

- Duhet të ziheni tani? - ndërhyri Petriti.

- Tamam, - shtoi Mariana.

- Po si tha: "Bebi im është i uritur", - ia bënte kamerierja tjetër duke vënë dorën te barku.

- E kishte fjalën për atë, - ia ktheu Mariana dhe tregoi me gisht tavanin.

- Uaaaaaaa, sikur nuk e kuptova unë! Po e di, moj, e di, - ia ktheu tjetra me ironi.

- Hë, filluat prapë ju? - ndërhyri për të dytën herë përgjegjësi.

- Ama dhe ti, neve na dëgjon, - i tha Mariana. - Ik e shiko shefin e arsimit se ia nxore darkën nga hundët.

- Vërtet, ku është ai?

- Në kaldajë, po ndihmon Lavdoshin!

Ia dha darkën me qëllim që t'i rregullonte vajzën në arsim. E bija ishte në vitin e fundit dhe ai donte ta përgatiste terrenin që tani. Nuk donte që kur të afrohej koha, shefi i arsimit t'i thoshte se je kujtuar vonë dhe se nuk kishte më vende të lira pune.

Petriti doli për të gjetur shefin e arsimit, por nuk shkoi shumë dhe u kthye mbrapsht me të shtyra nga një ushtar i cili u shfaq me vështrim dyshues te dera.

Në kuzhinë pluskoi qetësia dhe gratë bashkë me përgjegjësin nuk shkëmbyen asnjë fjalë. Mariana e dinte që po t'i afrohej, ai do ta shtynte me të njëjtën mënyrë që shtyu dhe përgjegjësin, prandaj nuk lëvizi vendit. Ca gjëra apo disa momente të vështira, kalohen më mirë me heshtje.

Nga sipër, hera-herës dëgjohej ndonjë gërralëvizje apo pupa këmbësh që shkelnin butësisht qetësinë e natës. Vinin të kthjellëta sikur t'i kishe përpara syve dhe mendjet e tyre hamendësonin dhe përfytyronin gjithfarësoj gjërash në lidhje me çiftin. Dhoma ministrore ndodhej në anën tjetër dhe gratë bashkë me përgjegjësin nuk e kuptonin përse gërralëvizjet apo të tjera gjëra si këto, dukej sikur ndodhnin mbi kokat e tyre?!

Dikur në derë u shfaq sërish ai ushtari me vështrimin dyshues.

- A do të hash? - e pyeti Mariana.

Tjetri nuk i ktheu përgjigje, vetëm sa e pa dhe u tërhoq pas.

Në mëngjes njerëzit e personelit ishin të lirë të lëviznin nëpër vilë. Madje i shërbyen ministrit në dhomën e ngrënies, duke ia zbukuruar tavolinën me një buqetë mimozash nga të parkut. Makinat ndezën motorët. Petriti numëroi plot dhjetë valixhe, gjysma e të cilave u vendosën në bagazhin e xhipit "Aro", ndërsa të tjerat poshtë sediljeve të minibusit me armatimet e gardës kombëtare. Në fund, ministri e kapi përgjegjësin nga faqet dhe i fali një buzëqeshje të akullt dhe me shumë kuptime. Petriti qe bërë statujë dhe ashtu, i hutuar, vazhdoi ta përshëndeste nga pas me tundje dore.

Kur rruga u zbraz, ai u kthye nga personeli dhe mezi priti për t'i pyetur:

- E patë gruan gjëkundi?

Ata mblodhën supet me habi.



DY TREGIME

Nga Sami Milloshi



NJË DITË SI SHUMË TË TJERA...

Sot është një ditë gri. Diell nuk duket kurrkund. Veç bie një borë e imtë si sheqer.

Me që nuk kemi ndonjë punë të madhe për të bërë, Daniela më tha se kishte dëshirë të ndiqnim sëbashku inaugurimin e presidentit. Tunda kokën në shenjë miratimi.

Dan, siç i them unë për shkurt, është një grua e ve që sapo i ka kaluar të gjashtëdhjetat. Nuk ka asgjë për t'u shënuar si e veçantë në pamje fizike. Por ka një kuriozitet të habitshëm për jetën private të të tjerëve. Ajo i tregon pa ngurresën më të vogël hollësitë e privacisë së saj. Sa herë më bie rasti ta takoj , gjëja e parë që vërej është nguti që ka të më tregojë se ose ka ndërruar shtëpi, ose dëshiron ta nderrojë .

Herën e fundit që e ndërroi shtepinë ishte bërë shkak një komshi. Ai, sipas Dan, ankohej se vajza e saj , shkaktonte trazira në katin e përbashkët ku banonin . Se për çfar trazirash e kishte fjalën unë asnjëherë nuk e mora vesh sepse Dan gjithherë kur e hapte këtë temë linte diçka të mjegullt.

Unë nuk kisha ndonjë kuriozitet të madh për natyrën e trazirave që ndoshta vërtet i shkaktonte vajza e Danielës. Thjesht dija se ajo i kishte kapërcyer të tridhjetëepesë vjetët dhe se koleksiononte pensionin që i kishte lënë babai i ndjerë. Ajo po ashtu ,siç më kishte thënë Dan, kishte plus një shumë parash që i merrte për shkak të një paaftësie mjeksore që nuk e lejonte të punonte.

- Punon jot bijë?- e pyesja unë Danielën sa herë ma hapte temën e trazirave të së bijës.

- Ta kam thënë me dhjetra herë - gjegjej Dan - që ajo nuk punon sepse ka justifikim nga doktori. Por ti, ose nuk dëgjon nga veshët ose nuk ke vëmendjen kur flas unë. Ti nuk je as francez, se kam dëgjuar se francezët nuk e dëgjojnë fare bashkëbiseduesin, por kur mbaron së foluri ai, thonë çfar u vjen nëpër mend...

- Nuk është as njera as tjetra - I them unë Danielës. - Thjesht unë jam i semurë i një lloji tjetër. Nuk dua ta ndërpres punën për veten time. Dhe cilido që më vjen përballë më bëhet ta pyes :" çfar pune bën ti?"

- Të isha unë në moshën tënde , do ta kisha lënë punën, do kisha dalë në pension- thotë Daniela me një lloj triumfialiteti .

- Edhe mund të dal- i them - por nuk kam vendosur ende se ku do ta kem varrin dhe kjo nuk është dilemë e vogël për mua.

- Po çfar dileme ke more zotëri ? Aty ku vdes aty varrosesh dhe kaq e thjeshtë është puna. Vjehrra ime do ta lerë Coloradon dhe do vijë te jetoje këtu në Massachusetts . Po e ndërron vendbanimin jo se do të vdesë pranë meje, por se ka shpresë se këtu mund ta kapërcejë një shekull jetë...

- Nuk është aq e thjeshtë i them. Ne kemi nje proverb në vendin ku jam lindur unë që thotë se " Guri i rënde peshon në vend të vet!"

- Mos do të më thuash se në pragun e vdekjes do të kthehesh andej nga ke ardhur?

- Nuk e thashë atë. Se nuk e dij pragun. Por kam dëgjuar nga disa miq të mij se është shumë bukur të vdesësh aty ku ke lindur...

- Gjepura - tha Daniela- vdekja njëlloj është për të gjithë : e shëmtuar, e dhimbshme...Dhe mizore!

- Po pse thonë disa që vdekja është kapak floriri?

- Sepse rrojnë me mite- tha Dan .- Ti duhet të kesh ndonjë arsye tjetër që nuk do të dalësh në pension, një arsye, të cilën nuk ma thua mua për kushedi se për çfar shkaku....

Më zuri ngushtë. E para herë që u dorëzova t'i them Danielës diçka që e mbaja sekret.

- E kam një arsye. I kam dhënë një premtim mikut tim John Stif kur ai ishte tetëdhjetëepesë vjeç dhe vazhdonte të punonte me mua.

- E ç' na qenka ky premtim?

- I kam thënë se do ta kisha si model kur të vinte puna për të vendosur se kur do të dilja në pension.

- Ti qenke i marrë, do vazhdosh të punosh deri në moshën tetëdhjetëepesë vjeç, si Johni?

- Mos thuaj ashtu Dan të lutem- Johni qe pasqyra ku unë shihja veten time. Si më la babai kur fluturoi në qiell , unë vetëm te Johni i kisha sytë. Sepse ai , njësoj si im atë,ngrihej që pa zbardhur drita , pinte një kafe, hante një çapë bukë dhe nisej në punë.

Johni kishte edhe endërra ...

- E çfar endërrash mund të ketë një njeri kur mbërrin dhe i kapërcen të tetëdhjetat?

- E ke gabim. Johni më tha një ditë se dëshironte të mësonte Spanjisht dhe të bëhej mesues Spanjishteje... Më ka befasuar aq shumë me atë ëndërr sa më ka lënë të shastisur dhe, që prej asaj dite unë jam tjetër njeri...Në fillim më kapi gazi dhe ashtu me një qesëndisje të butë i thashë:" John ti je bash në lulen e rinisë, mund të bëhesh mësues i shkëlqyer Spanjishteje. Madje mund të përkthesh edhe Markezin dhe Rulfon...

Ai e kuptoi dhe ma ktheu " Mos u tall, e kam seriozisht që dua ta mësoj Spanjishten..." Dhe heshta i trembur që e teprova me shakanë time.

- Johni paska qenë si vjehrra ime. Ajo i ka mbushur nëntëdhjetëetre vjeç dhe përsëri thotë se kur të mos jetë në gjendje të ngasë makinën e saj , do futet në një kurs të marrë një patentë për pilote. " Nuk dua të vdes pa ngarë një çarter timin" më tha një ditë...

- Lum ti çfar vjehrre paske - i thashë unë Danielës , dhe u kujtova se i kishim premtuar njëri tjetrit të shihnim inaugurimin e presidentit.

Pashë orën. Ishin mbushur plot tre orë që Daniela dhe unë kishim biseduar kodra pas bregut të harruar nëpër mite e nëpër proverba.

Kur Daniela e hapi televizorin të shihnim ceremoninë e inaugurimit të presidentit, gjithshka kishte mbaruar.

Ishim tepër vonë.

Jashtë sheqeri i deborës kishte mbuluar barin e tharë të kampusit të universitetit.

PESË VJET NË MOSHËN TIME

Nuk e mbaj mend se sa herë më kishte pyetur Josh se ç'moshë kisha, por sa herë që më pyeste i përgjigjesha me një kundërpyetje:

- Sa thua ti Josh?

Ai zakonisht m'i ulte nja pesë vjet, por unë asnjëherë nuk e mora vesh arsyen se pse m'i ulte vitet e moshës: donte të më bënte qejfin apo vërtet ashtu i dukesha. Pastaj , si e mësonte të vërtetën ,me një tis të mjegullt trishtimi në sy më bënte një pyetje tjetër:

- Çfar do të bëje ti me këto pesë vjet që t'i ula unë, sikur ta fillojë jetën nga e para?

- Varet se ku është ky pesë vjetësh - i thosha unë.- Po të isha pesë vjeç do t'i lutesha babait të m'i tregonte përrallat më mirë, sepse për çudi nuk e mbaj mend plotësisht asnjë nga përrallat që më tregonte ai.

- Po pse ,nuk t'i tregonte mirë përrallat babai?

- Pikërisht.Atëhere unë nuk e dija arsyen. Tani e di.

- Dhe cila ishte?

- Ngaqë ai kishte mbetur jetim. Ia kishin vrarë babain. Atij nuk i kishte treguar përralla babai. Dhe, ato që më tregonte ai mua , më shumë ishin sajime të tij , se sa ishin përralla...

Kjo është arsyeja që edhe unë nuk dij të tregoj përralla. Dhe gjithë këtë gjëmë unë e gjej tek plumbi që i mori jetën gjyshit.

- Dyshoj - thoshte Josh si filozof i lashtë- Je i sigurtë ti që po të mos qe vrarë gjyshi yt, yt atë do të dinte t'i tregonte përrallat?

- Po - i gjegjesha unë - Së paku jo të gjitha përrallat që më tregonte do të kishin një fund të lumtur. Ato fundet e përrallave, ishin njësoj dhe për mua prandaj ishin edhe të mërzitshme. Në fund babai gjithnjë thoshte " Dhe ata u martuan, bënë shumë fëmijë dhe rrojtën të lumtur"...

Atëhere unë nuk e merrja vesh pse babai i mbyllte me lumturi përrallat, por tani e di arsyen.

-Dhe cila është? pyeste Josh.

- Ai nuk donte që unë të mbetesha jetim , si ai - ishte gjegja ime.

Josh është bosi im. Është nja dhjetë vjet më i ri se unë. Kapelja me strehë ia tregon moshën e vërtetë. Por , kur ai e heq kapelen i duket rrafshi pa flokë i kokës, dhe një vijë thinjash pas, që e bëjnë të duket po aq sa e kam moshën unë...Pra, dhjetë vjet më i vjetër nga sa është në të vërtetë.

Dje u kujtua sërish të më pyeste se cfar do të kisha bërë unë me ato pesë vjet që më tregojnë më të ri nëse do ta rifilloja jetën në moshën njëzet vjeç.

- Do të isha martuar - Josh- dhe do bëja më shumë fëmijë sepse e kam peng që nuk ia kreva amanetin gjyshes.

- Po pse nuk ia kreve ti amanetin gjyshes?

- Kur unë u bëra me fëmijën e dytë, gjyshja qe verbuar. Nuk mund ta shihte djalin tim. Por, ajo më tha se "kur të bësh tjetrin, të tretin, do të më kthehet shikimi, dhe kur të bësh të katërtin do të shoh edhe hënën si bukë çerepi në qiell dhe do ta pres një dash për ty..."

Unë u martova vonë, dhjetë vjet më vonë nga mosha që do kisha zgjedhur të martohesha me mendjen që kam sot.

Dhe gjyshja iku e verbër nga kjo Botë.

- Duket sikur të ka mbetur peng- tha Josh.

- Më i madhi peng që më ka mbetur- i thashë.

Më dhimbset Josh se nuk ka cfar të tregojë për veten. Nuk e dij pse, po ai gjithnjë kërkon të zhytet si polumbar në moshën time, a thua se do të gjejë në fund të detit ndonjë relike nga anija e mbytur e jetës së vet.

Tani që ka rënë pandemia e ka pushtuar një ankth i madh për veten. Dje më tha se kishte parë në ëndërr sikur vendi i tij i punës qe shkurtuar dhe ai kishte mbetur pa para dhe qe bërë skllav në fushat e pambukut.

- Brother- sheh ti endërra të këqia si këto që shoh unë? - më pyeti Josh.

- Shoh endërra - i thashë- por unë kam një të keqe se i tjetërsoj ato kur ua tregoj të tjerëve. Të gjitha endërrat që shoh unë kanë fund të lumtur, njësoj si fundet e mërzitshme të përrallave që më tregonte babai në fëmini. Merita është e atij , jo e imja...

- Çfar do të bëje ti po t'i shtoje moshës që ke ato pesë vjet që të tregojnë më të ri nga sa je?

- Do të vazhdoja të punoja sepse nuk dua të shoh endërrat që sheh ti duke mbledhur pambuk për skllavopronarin në fushën ku të përvëlon zhegu...

- Lum ti - tha Josh- ty të ka bekuar babai me ato fundet e lumtura të përrallave.

- Ato nuk qenë përralla Josh. Ishin e vërteta e jetës së tij prej skllavi. Ai thjesht nuk donte që edhe unë të bëja një jetë skllavi...

- Kam shumë frikë, brother- tha Josh- unë shoh endërra të këqia.

- Unë nuk kam më moshë të bëhem skllav përsëri , Josh. Ti je më i ri se unë....Në u bëfsha unë përsëri skllav, gjithë enigma mbetet tek ai plumbi që mori jetën e gjyshit tim.

Atë plumb kurrkush nuk e gjeti më. U ndryshk diku në shpat të kodrës me lajthi. Dhe mbeti aty më shumë se një shekull. Pikërisht aty ku rrodhi currili I valë i gjakut prej gjoksit të gjyshit...

NË IZOLIMIN E HOTEL DAJTIT

Nga Odile Daniel

Erdha në mbrëmje në Hotel Dajti, ku u ktheva në dhomën time me mobilie modeste. Dola në ballkon dhe mora frymë thellë. Ajri i mbrëmjes ishte i freskët, i mbushur me aromën e pishave që rrethonin hotelin. Nuk kishte asnjë zhurmë. Dëgjoheshin vetëm boritë, por këto mund të ishin vetëm taksi, vetura ministrore ose autobusë të vjetër sovjetikë a nga vendet e Lindjes që tërhiqnin vëmendjen e kalimtarëve, të cilët, jo shumë të mësuar me qarkullimin e automjeteve, e kalonin rrugën pa u ruajtur. Kohë pas kohe, dëgjohej e lehura e një qeni diku larg. Nga dritarja e dhomës sime, shihja një fushë sporti në hijen e disa plepave dhe shtëpitë e ulëta të qytetit të vjetër, pastaj masivi sublim i Dajtit që mbizotëronte kryeqytetin. Cicërimat e dallëndysheve që vinin përqark në qiell në mbrëmje më jepnin një ndjesi trishtimi dhe ankthi. Në vend që të ma qetësonte shpirtin, shfaqja më jepte një përshtypje të rreme qetësie, sepse heshtja në qytet më dukej e dyshimtë, e ngarkuar me dhimbje dhe vuajtje. Në atë vit 1965, me hapësirat e saj të shumta të gjelbëruara, Tirana dukej si një kopsht i madh. Mos vallë kjo ishte parajsa ekologjike, siç e imagjinonin turistët e grupeve marksiste-leniniste të ardhur në Francë? Madje kisha dëgjuar në sallën e ngrënies së hotelit një çift që, duke qenë pjesëtarë të njërit prej këtyre grupeve të pritur mirë dhe të ngopur deri në fyt, të thoshin se do të donin të vendoseshin në Shqipëri për t'i mbyllur këtu ditët e pensionit të tyre. U kujdesa që të mos më gënjente pamja e jashtme e gjërave.

Pak nga pak, po filloja të krijoja një mendim. Ndjeja një dyzim të madh ndjenjash; nga njëra anë, dashuria ime për historinë dhe kulturën shqiptare dhe respekti për shpirtin trim dhe hapjen që kishin treguar shqiptarët gjatë historisë dhe, nga ana tjetër, vuajtja për një realitet të dhimbshëm, atë të mbylljes, të peshës së një ideologjie shtrënguese dhe shtypëse, të imponimit të një të vërtete të mbështetur në gënjeshtrën që përpiqej veçse të shkatërronte dhe të shembte për të ndërtuar një të ashtuquajtur botë të re. Atmosfera e qetë e hotelit ishte e rëndë. Hoteli mund të dukej si një qendër ndalimi e të huajve që spiunoheshin nëpër ambientet e tij dhe përgjoheshin në vajtje-ardhjet e tyre. Edhe jashtë, ruhesha, sepse ndiqesha vazhdimisht dhe, për më tepër, njerëzit shpesh m'i ngulnin sytë plot kërshëri dhe ndonjëherë me frikë. Ata nxitonin hapin për të m'u larguar, duke më marrë për një pjesëtare të personelit diplomatik që ishte e ndaluar të frekuentohej. Marrëdhëniet e mia me udhërrëfyesin tim Besnik ishin shumë të rezervuara. Ai kishte një qëndrim shumë të përmbajtur. Kurrë nuk futej në fushën e politikës. Mjaftohej të më shoqëronte, të më lehtësonte përpjekjet për punën time. Donte të kryente misionin e tij si udhërrëfyes në mënyrën më të mirë, padyshim për karrierën e tij, por ruhej vazhdimisht dhe gjithmonë kisha përshtypjen që ndiente njëfarë bezdie që, gjithashtu, po përpiqesha ta analizoja. Qëndrimi i tij i ngurtë më dukej i dykuptimtë. Kuptoja që, padyshim, ai nuk ishte një ideolog i bindur. Isha e ndërgjegjshme që duhej të bënte një raport të përditshëm për autoritetet, jo thjesht universitare, por dhe policore, dhe se duhet t'u trembej kritikave të tyre.

Ngushëllohesha nga mendimet e mia të trishta duke soditur masivin e Dajtit çdo mbrëmje në perëndim. Çfarë ngushëllimi! Ky mal kaq i bukur, kaq gjallërues, me gurët që, kur vinte mbrëmja, merrnin një ngjyrë të purpurt që alternohej me nuanca blu. Ai më sillte ndër mend madhështinë e malit Sainte Victoire të pikturuar nga Césanne. Mali i Dajtit mishëronte guximin dhe krenarinë e malësorëve shqiptarë, qëndrueshmërinë e zakoneve të tyre që ata kishin ia kishin dalë t'i ruanin në malet e veriut. Mendoja për vendosmërinë e treguar në mbrojtjen e tokave të tyre dhe për shpirtin e tyre luftarak gjatë periudhës së sundimit otoman për të vazhduar të vetë-administrohen sipas ligjeve të tyre vjetra, kanunit të Lekë Dukagjinit. Tonet vjollcë të masivit shprehnin ndjenjat e mia të trishtimit dhe hidhërimit të shkaktuara nga egërsia e një ideologjie pa kompromis, nga thatësia e mendimit politik në fuqi, i ashpër, çnjerëzor dhe barbar. Si ishte e mundur që Shqipëria, me aq vlera qëndrese, të ndodhej në atë gjendje skllavërimi dhe dremitjeje që konstatoja? Sidoqoftë, asgjë s'më bënte që të shkëputesha nga lidhja ime e thellë me këtë vend dhe provoja një ndjenjë të fortë dhembshurie.

Zbrita të darkoja. Disa persona që punonin në ambasada vinin të darkonin në restorantin e Hotel Dajtit për t'u zbavitur dhe për të përfituar nga dekori dhe ushqimi i tij i mirë. M'u afrua një diplomat egjiptian që ndihej i izoluar dhe që, meqë fliste frëngjisht, më kërkoi të ulej në tryezën time. Mësova se ai s'kishte të drejtë të qarkullonte më larg se njëfarë perimetri rreth kryeqytetit. I njëjti ndalim mbizotëronte në Bashkimin Sovjetik për diplomatët dhe të huajt. Një agjent tregtar francez nuk pushonte së ngrituri nga tryeza për të shkuar te recepsioni ku priste me telefon porositë dhe datat e lëvrimit të bretkosave, kërmijve dhe gështenjave shqiptare. Ankohej se duhet të qëndronte më shumë se ç'duhej, i mbyllur në këtë hotel të frikshëm, sepse pajisjet e kullës së vogël të kontrollit të aeroportit që ishte ndërtuar në kohën e mbretit Zog, nuk ishin përmirësuar, gjë që i pengonte avionët të ngriheshin apo të uleshin në rast mjegulle dhe lidhjet ajrore me vendet e huaja ishin të rralla. Nga diplomati egjiptian mësova se burri i ulur në një tryezë tjetër ishte një holandez që ndodhej në Tiranë për t'u shitur shqiptarëve fara patatesh.

Menyja e restorantit ishte e shtypur me një makinë shkrimi të cilës po i mbaronte boja, por sidoqoftë mund ta lexoja me afërsi listën e gjellëve: *antipasto* të ndryshme, makarona, taliatele, spageti. Mos vallë ishim në Itali? Shqiptarët e vlerësonin Italinë, me gjithë kujtimin që ushtritë e Musolinit kishin pushtuar vendin e tyre më 1939. Shumë shqiptarë flisnin italisht dhe intelektualë të ndryshëm, tashmë të moshuar, kishin ndjekur studimet në universitetet italiane, gjë që ishte gjithashtu një njollë në biografi për shumë prej tyre që ishin persekutuar. Mishrat e menysë: viçi, lope apo qengji, ishin shumë të shijshme. Nuk mungonin as gjellët me tingëllim të huaj: *involtini meksikane* apo eskalopë meksikanë, *biftek Bismark, gulash me zarzavate*. Mishrat ishin vërtet të shijshëm, pasi vinin nga kafshë të ushqyera në mënyrë natyrore. Më pëlqente të shijoja gjellët me ndikim oriental, si *tasqebapi* ose *shishqebapi* apo *qoftet*. Më pëlqente *supa e orizit*, një lëng mishi ku ishte zier orizi dhe ku hidhej limon, majdanoz,

piper i zi dhe një e verdhë veze. Edhe *byrekët*, këto lloj petësh të mbushura me djathë ose spinaq që shqiptarët kishin zakon t'i bënin në shtëpi dhe që ishin të shijshme, figuronin rrallë në menytë e hotelit që ofronin sidomos kuzhinë ndërkombëtare për vizitorë të huaj, shumica tregtarë. Gatimi me vaj ulliri u jepte një shije të hatashme gjellëve që përgatiteshin në hotel, sepse shitja e prodhimeve ushqimore të ngrira nuk ekzistonte në Shqipëri në atë kohë. Holandezi kishte porositur një birrë që vinte nga kombinati ushqimor i Tiranës ose nga fabrika e Korçës. Menyja propozonte si pije: *raki rrushi*, shpesh nga Përmeti që është më e mira, *verë Pogradeci*, *konjak Skënderbeu*, *birra Korça.* Unë porosisja një shishe me ujë burimi ose *portokallatë*, lëng portokalli të shtrydhur, sepse në këtë vend nuk kishte as coca-cola, as pije të gazuara. Propaganda i bënte shqiptarët të besonin se coca-cola ishte një drogë e konsumuar në Amerikën dekadente.

Ndërsa haja pranë diplomatit egjiptian, na u prezantua një burrë që na përshëndeti dhe u bashkua me shoqërinë tonë. Ishte një belg i dërguar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Diskutimi u bë mbi shëndetin e popullit shqiptar dhe sidomos të fëmijëve. Belgu kishte vënë re se në fshatra kishte shumë fëmijë shëndetligj. I thashë se e kisha zakon të huaja libra në bibliotekën kombëtare për të punuar mbrëmjeve në dhomën time dhe se kisha zbuluar në vjetarin statistikor të vitit 1964 një rubrikë që fliste për vdekshmërinë foshnjore. Ajo ishte në atë kohë shumë e lartë, prej 7%. Raportet mbi rezultatet e planeve pesëvjeçare ishin shumë të kënaqshme, por duhet të dije të lexoje midis rreshtave për të zbuluar ndonjë realitet. Shqipëria vuante nga periudhat e thatësisë. Organizimi i bujqësisë kolektive nuk lejonte të mbuloheshin nevojat ushqimore të popullsisë. Gjatë itinerarit tim për të shkuar në Krujë, dobësia e fëmijëve më kishte bërë përshtypje të madhe. I propozova belgut t'i huaja vjetarin pasi të kisha përkthyer disa rubrika që mendoja se mund t'i interesonin. Vendi i tij ndoshta do të mund të sillte ndihmë ushqimore.

Shkova shpejt në dhomën time për të punuar. Më kishte zënë gjumi prej shumë orësh; duhet të ishte mesnatë kur, befas, dëgjova zhurmë. Dikush trokiti në derën time duke thirrur: "Zonjë, Zonjë !" me një zë të huaj. Meqë recepsioni nuk përgjigjej më pas orës njëmbëdhjetë të mbrëmjes dhe padyshim aty s'kishte njeri për t'u kujdesur për klientët, më kapi frika. Vendosa të bëja si e vdekur. E dëgjova personin që trokiste të këmbëngulte duke shqiptuar disa fjalë duke e goditur fort derën. Nuk ishte për të kërkuar ndihmë, sepse goditjet ishin të dhunshme, sikur t'i bënte me një shkop hekuri dhe zëri dukej si i ndonjë të piri. M'u kujtua befas që kisha parë në sallën e restorantit, gjatë darkës, një polak që ecte me shkop. Kishte porositur shumë gota me raki dhe një shishe verë. Ai ishte ndoshta pas derës sime dhe donte padyshim të përfundonte në dhomën time një mbrëmje të lagur mirë. Duke u trembur për më të keqen, domethënë se mos na shqyente derën, dhe duke menduar të mbrohesha, mora një hekur hekurosjeje shumë të rëndë të prodhuar në Gjermaninë Lindore që e kisha blerë në dyqanin e madh MAPO (magazina popullore) të Tiranës. Pas një copë here, dëgjova burrin që, duke konstatuar se përpjekjet e tij ishte të pafrytshme, u kthye në dhomën e tij që duhej të ishte ngjitur me timen, sepse dëgjova sakaq zhurmat e ujit nga banja, muri i së cilës ishte ngjitur me timen. Të nesërmen, kur po haja mëngjes, u çudita shumë kur polaku në fjalë hyri në sallën e restorantit dhe erdhi drejt e në tryezën time për të më puthur dorën. Atmosfera e izoluar e Hotel Dajtit, mungesa e zbavitjeve dhe marrja e gotave të shumta me raki kishte zgjuar tek ai nevojën e shfryrjes që kishte të bënte me mua, sepse unë isha, në pjesën më të madhe të kohës, e vetmja grua e huaj që banonte në hotel. Tash e tutje duhet të ruhesha vazhdimisht, edhe natën në hotel.

Kishte ardhur e diela. Besniku nuk kishte parashikuar asgjë për atë ditë. Nuk më vinte keq që do të kisha ca liri. Për t'i shpëtuar gjendjes së izolimit që ndieja në hotel, vendosa të shkoja në mëngjes në kishën katolike dhe të përzihesha me turmën e besimtarëve shqiptarë. Shteti shqiptar kishte vepruar si Bashkimi Sovjetik, duke i detyruar bashkësitë fetare t'i nënshtroheshin ligjit të shtetit dhe të miratonin statute ku ndihej vula e pushtetit komunist. Kishin mbetur shumë pak kisha të hapura. Kalova në fillim para maternitetit të Tiranës. Nënat e reja tundnin në dritaret të porsalindurit e tyre dhe baballarët e rinj, poshtë maternitetit ose në këmbë në trotuarin përballë ndërtesës, përshëndesnin mamatë dhe lëshonin britma admirimi duke parë fëmijët e tyre. Ata nuk lejoheshin të hynin në maternitet si masë profilaktike. U drejtova drejt një kishe të vogël që ndodhej në lagjen pas bulevardit të mbushur me ndërtesa moderne që çonte te stacioni i trenit. Duke u përpjekur t'i shpëtoja ndonjë njeriu të *Sigurimit* që mund të më ishte vënë pas, bëra disa kthesa nëpër rrugica, pastaj zgjodha të futesha sa hap e mbyll sytë në një rrugë të lagjes së vjetër. Më në fund, hyra në kishën që ishte gjysmë e mbushur për meshën e së dielës. Prifti ndihmohej nga djem të rinj me veshje të kuqe dhe rasë të bardhë. Kur erdhi çasti i kungimit, nga turma e besimtarëve, më së shumti persona të moshuar, ia behu një burrë i vetëm që u ul në gjunjë për t'u kunguar. Kisha parë në vitin 1963 kisha ruse të kthyera në palestra, kinema ose depo drithërash. Më kujtohej se kisha marrë pjesë në një meshë në një kishë të Kievit. Ceremonia kishte zgjatur dy orë. Të moshuar që i ngjanin Tolstoit ishin në gjendje ekstaze dhe m'u duk vetja e kthyer në Rusinë e Vjetër. Papritmas, një burrë me pamje mjaft të mjerueshme kishte ardhur të përkulej para ikonostasit. Kish bërë shenjën e kryqit, kishte lëshuar një britmë dhe kishte rënë përtokë, i mbytur në lot. Pastaj ishte çuar dhe kish puthur ikonat. Kur po dilnim, njerëzit më kishin pyetur nëse kishat ishin të hapura në Francë dhe një vajzë e re më kishte thënë se kishte frikë mos e hiqnin nga puna, sepse kishte shkuar në meshë. Këtu pashë që gjendja ishte më e keqe. Njerëzit nuk guxuan t'i afroheshin altarit për t'u kunguar. Askush nuk kishte guxuar të më fliste në dalje të kishës si në B.R.S.S. Të krishterët ishin të përndjekur. Duke e parë këtë burrë të vetëm të kungohej, thashë me vete: "Çfarë guximi ".

Dola nga kisha dhe, duke menduar sërish se rrezikoja të ndiqesha, vendosa që, para se të shkoja prapë në Hotel Dajti, të bëja një hile duke ecur nëpër rrugicat e vogla të lagjes së vjetër. Kjo zgjedhje sigurisht ishte e kotë. Më pushtoi një ndjenjë e thellë trishtimi, por sa më shumë konstatoja veset e regjimit, aq më shumë kisha dhembshuri për vuajtjet e njerëzve dhe aq më shumë më shtohej pasioni për Shqipërinë.



Përktheu Tomi Nakuçi

MIQ TË PËRZEMËRT

Tregim nga Jane Gardam

Përktheu nga origjinali
Aristidh Shqevi

Kur Francis Phipps doli në pension, ai dhe bashkëshortja e tij, Patricia, vendosën të kalonin një javë me pushime në ishujt Scilly. Ishin një çift i matur, ndaj dhe dhomën e hotelit e kishin prenotuar që nga vera e shkuar. Vite më parë, ata gjithmonë i kishin kaluar pushimet gjatë stinës së verës në ishujt Scilly, bashkë me fëmijët e tyre, të cilët tashmë ishin shpërndarë me sukses në të katër anët e botës.

Patricia nuk ishte treguar dhe aq entuziaste për këtë udhëtim që vinte pas shumë vitesh (dhe për rrugën e gjatë që së bashku do ta përshkonin me makinë). Sipas saj, kishte gjasë që udhëtimi të ishte një udhëtim i mërzitshëm. 'Marrëzira! Për mua është më bukur që të shkojmë sërish në ishujt Scilly, me para të mjaftueshme për t'i përballuar shpenzimet që kërkon një hotel luksoz, se sa të frekuentojmë një bar me një banjë të vetme dhe një dysheme të mbushur me rërë,' tha Francis.

'Do të marrim goxha libra me vete,' tha ai. 'Narcisat do të jenë në kulmin e lulëzimit. Do të bëjmë shëtitje. Ushqimi besoj se do të jetë i mrekullueshëm, dhe nëse do fati, nuk do të gjejmë turma të mëdha njerëzish.'

Në të vërtetë bënte ftohtë. Dhoma ishte fantastike, por ajo ndodhej në fund të një korridori ku fishkëllente erë; në muret e korridoreve të tjerë kishte tri dritare me pamje nga deti. Ishte një det i keq, rropama e dallgëve dëgjohej bashkë me një zhurmë të mbytur tek dallgët përplaseshin me vetë themelet e hotelit njëkatësh, gjë që të krijonte përshtypjen se, në një farë mënyre, ato lartësoheshin mbi shtratin ku ata ende qëndronin të shtrirë. Përtej valëve spërkatëse, ata ishin në gjendje ta shikonin shkëlqimin verbues si edhe lëbyrjen e tyre larg në horizont. Dukej sikur çifti Phipps kolovitej bashkë me detin sa herë që ata mbyllnin sytë.

Çdo ditë dilnin për shëtitje përgjatë rrugëve të ngushta që fshikulloheshin nga era e detit dhe prania e ajrit të ftohtë; narcisat, thuajse të rrafshuara me tokën, lëkundeshin nga rrëketë e vogla, vorbullat e erës dhe përroskat. Ushtima e erës dëgjohej pas çdo shkëmbi të kuq dhe pas çdo gardhi të papërkulshëm që përbëhej nga escallonia halore të zeza.

Pas drekës ata binin në gjumë. Pas darkës secili lexonte librin e vet. Komunikimi në mjediset e hotelit bëhej me shumë takt, por ndonëse ai ishte gjithmonë i mbushur me njerëz, dukej i zbrazur. Në hotel ndodheshin do çifte të tjerë që ishin moshatarë me bashkëshortët Phipps, siç ishte një shkrimtar nervoz, me një trup të vogël dhe flokë kaçurrela në ngjyrë gri të errët, një grua me një pamje të trishtuar, e cila, fustanin e kaltër prej leshi që mbante veshur e kishte zbukuruar me një palë rruaza, si edhe një çift nga Yorkshire; ajo ishte e bëshme në trup dhe e dashur, ai, thatanik dhe i zymtë. Gruaja buzëqeshi me lakmi nga ana tjetër e restorantit në drejtim të bashkëshortëve Phipps.

'Pak ogurzezë gruaja,' tha Francis. 'Duket sikur do të dëshironte *të ndante ndonjë të fshehtë* me ne.'

'Fare mirë mund të mbajmë distancë nga ajo,' tha Patricia.

Patricia ishte e lodhur. Mbrëmjet e vogla, por madhështore që ata kishin organizuar gjatë muajve të fundit me rastin e daljes së Francis-it në pension, i kishin drobitur që të dy. Që nga koha e universitetit, ku ishin njohur para dyzetë vitesh, Francis i kishte shërbyer vendit të tij dhe Departamentit ku ai kishte punuar, ndërkohë që Pat-i ishte kujdesur për të. Arritja e saj kishte qenë krijimi i përkatësisë së tij, e cila ishte shtëpia e qetë në Dulwich, si edhe mikpritja e hijshme. Në kopshtin e gjatë e të gjelbër kishte një shtrat të varur prej pëlhure që ishte lidhur ndërmjet një peme arre dhe një dardhe.

Dy netë përpara fundit të pushimeve, Pat-i ndjeu një përmallje për t'u kthyer në kopshtin e saj, ndërsa Francis, në të njëjtin çast, tek mbante derën hapur që ajo të kalonte në korridor meqë ishin *en route* për darkë, tha, 'Unë do të thoja se një javë këtu ishte më se e mjaftueshme për ne. A je dakord me mua Patricia?'

Gjithsesi, në mbrëmje, njëfarë shpengimi sundonte në sallën e ngrënies. Në kohën që ata u futën aty, dikush po qeshte me zë të ulët, ndërsa romancieri thinjosh, i veshur me një kostum prej kadifeje të zezë, po pinte kafe nga filxhani i gruas, e cila kishte veshur një fustan të modës së lartë dhe qëndronte ulur në të njëjtën tavolinë me të. Gruaja nga Yorkshire, me fytyrë të përkuqur nga moti, dukej e etur për bisedë më shumë se kurrë; më në fund, ajo thirri me zë të lartë, në mënyrë të paturpshme, dhe në distancë nga tavolina e saj në drejtim të bashkëshortëve Phipps duke thënë se pushimet për të pothuajse kishin përfunduar; pyeti gjithashtu nëse pushimet e çiftit Phipps kishin marrë fund. Ajo shtoi se duhej të kthehej në Boroughbridge të shtunën për të marrë rezultatet e analizave.

'Oh,' tha Pat-i. 'Rezultatet e analizave?'

'Druhem se po. Kam bërë një kontroll mjekësor. Jemi të dy kureshtarë ta dimë se ÇFARË DO TË KENË GJETUR.'

Francis mori pecetën në dorë, Pat-i ngriti menynë. Në çastin që i mënjanoi sytë nga menyja, ajo ndeshi vështrimin e çifteve të tjerë që ndodheshin të ulur në tavolinën përballë mbi të cilën binte hija e shkallëve kërmillore. Gruaja i buzëqeshi si të ishte motra e saj. Për një çast, Patricia pati përshtypjen se gruaja përballë po shikonte me ngulm gotën e saj.

Kur çifti u ngrit nga tavolina, burri u avit pranë Franicis-it dhe i buzëqeshi atij. 'Mirëmbrëma.'

'Mirëmbrëma.'

Gruaja iu drejtua Patricia-s me fjalët, 'Kam frikë se oreksi për biseda rritet çdo të enjte. Kini kujdes nga njerëzit që ushtrojnë ndikim!'

Pak më vonë, të katërt së bashku u ndodhën në sallën e televizorit, në pritje të Emisionit të Lajmeve, dhe të personit tjetër (Phillips – Jocelyn Phillips. Kjo është gruaja ime – Evelyn-a'), i cili tha se Emisionin e Lajmeve nuk e duronte dot më.

'Ulemi për ta parë emisionin dhe tmerrohemi,' tha Francis. 'Kemi frikë për fëmijët tanë.'

'Po flisni tamam si Jocelyn-i,' tha bashkëshortja. 'Më lejoni të marr me mend diçka. Mos jeni avokat? Apo gjykatës?

'Zyrtar shtetëror. Sapo kam dalë në pension.'

'Edhe unë gjithashtu,' tha Phillips. Kam punuar në Ministrinë e Jashtme. U bë një vit që kam dalë në pension.'

Të dy burrat sollën pije për njëri tjetrin, ndërsa gratë morën nga një pije liker. Biseda rrodhi qetë-qetë. Dukeshin si miq të vjetër.

Të nesërmen, të katërt së bashku dolën për shëtitje në kopshtin tropikal; Evelyn-a dhe Pat-i zbuluan se kishin një interes të përbashkët, zambakët. Natyrisht u takuan sërish për darkë, dhe kur erdhi ora për të fjetur, Jocelyn Phillips u shpreh se të gjithë kishin kaluar një ditë shumë të bukur. Francis, i cili prej vitesh konsiderohej si një njeri shumë i mbyllur, tha se, 'Takimi me ta ishte një gjë e mrekullueshme.'

Të nesërmen, gjatë vaktit të mëngjesit, tek po i afrohej tavolinës së bashkëshortëve Phipps, Evelyn-a tha, 'Më dëgjoni pak. Besoj se nuk na konsideroni njerëz me cilësi të jashtëzakonshme, por megjithatë ne kemi menduar që sonte të vini për darkë në shtëpinë tonë. Rruga e kthimit është pothuajse e njëjta si për ju ashtu

edhe për ne, dhe në këtë mënyrë ju do ta thyenit disi udhëtimin e lodhshëm.'

Francis, i cili ishte akoma në këmbë me pecetën që mbante shtrënguar në dorë, tha, 'Jeni me të vërtetë shumë të mirë.'

'Ide e shkëlqyer,' thirri Jocelyn-i nga distanca.

Tek recepsioni, pasi bënë pagesat përkatëse, ata u kthyen nga njëri-tjetri.

'E dini çka – ' tha Francis. 'Nëse vërtet e keni seriozisht - ?'

'*Sigurisht* që po. Na lejoni vetëm një orë sa të përgatitim plaçkat.'

'Atëherë, e gjitha kjo është aq miqësore...Pat- ?'

'Pa asnjë dyshim që më pëlqen.'

Pasi u dha adresa dhe udhëzimet e rastit, të gjithë hipën në helikopterin që do t'i çonte në Penzance, atje ku kishin parkuar makinat. Pat-i u befasua kur pa se gruaja me fustanin e modës së lartë, si edhe shkrimtari, u përshëndetën përzemërsisht me çiftin nga Yorkshire. Ajo dhe Francis përshëndetën me dorë bashkëshortët Phillips, dhe më pas udhëtuan drejt fshatit më të afërt për të blerë si dhuratë një vazo me lule.

'Kjo që po bëjmë nuk është aspak normale,' tha Pat-i. 'Çfarë do të thonin fëmijët për këtë? Ata mund të jenë *kushdo*. Vrasës në seri. Në një farë mënyre – a e vure re se dukeshin pak ...të ftohtë, në momentin kur ikën? Pak të largët?'

'Gjepura,' tha ai. Ata janë tërësisht si ne. Ky është një fat i madh. Vështirë të gjesh njerëz si vetja sot.'

Pat-i solli ndërmend romancierin, gruan e pasur dhe çiftin nga Yorkshire. Asnjëri prej tyre nuk i kishte thënë mirupafshim. Papritur u ndje si një e mjerë. E vetmuar.

Pas shumë kilometrash, kur kishin depërtuar thellë në Devonshire, më në fund Francis tha 'E po...ma do mendja, këtu *ka* njëfarë rreziku. "Mos u ngatërro kurrë me njerëz që takon gjatë pushimeve", e kështu me radhë. Ama, u bënë vite që nuk kemi takuar njerëz të tillë me të cilët ndjehesh kaq bukur. Më duket se arritëm tek kthesa e tyre, apo jo?'

Dalja nga autostrada ishte shumë afër, ndaj dhe ai e nxori mjetin drejt saj me shumë shpejtësi. Ashtu siç e kishte bërë zakon të shprehej, ajo tha, ' Nuk më pëlqen fare mënyra se si ti del nga autostrada. Duhet të ma lësh mua timonin. Zakonisht ai nuk përgjigjej, por këtë herë tha, 'Kam pak problem me nyjën e dorës. Trafiku nuk është më ai i dikurshmi. Më duhet ta pohoj se drejtimin e makinës nuk e shijoj më. Herë tjetër do të udhëtojmë me tren.'

Kështu ata u futën në rrugën-A, më pas në rreth-rrotullim e në rrugën anësore, dhe nga aty – po, aty ishte – kthesa që të shpinte në shtëpinë e tyre (pa tabela njoftuese) nëpërmjet rrugicës së vogël.

Rrugica e vogël ishte e gjatë. Ajo kishte kthesa të forta si korridoret e hotelit. Vinte duke u ngushtuar, por ishte e lënë pas dore. Në mes të saj kishte një damar të ngritur mbi të cilin rritej bari. Gardhi i gjelbër i linte vendin një rrethimi fushor metalik nëpërmjet së cilës binte në pah një shtëpi me tulla të kuqe dhe dritare të pajisura nga jashtë me një thurimë shufrash të hekurta, e vendosur goxha në largësi nga rruga dhe rrethuar nga bari. Dera kryesore dhe dera e pasme ishin krejtësisht të hapura, gjë që bënte të mundur të shikoje një kalim të shtruar me pllaka të mëdha guri, i cili përfundonte në fushat e gjelbra prapa shtëpisë.

'A thua të jetë kjo një shtëpi origjinale?' pyeti Pat-i. 'Apo një shtëpi me pajisje dhe dekor të brendshëm të stilit psudo-Dudo?'

'Nuk di ç'të them,' u përgjigj ai. 'Do të ishte shumë tërheqëse nëse i përket tipit pseudo.'

Në heshtje të plotë ata zbritën nga makina. Kokërdhojat përpara shtëpisë dukeshin si lule të pikturuara në faqen e një kalendari.

'Shtëpia është bosh,' tha ajo. 'Mundet që ata të jenë akoma në rrugë e sipër.' 'Nuk ka mundësi,' tha Francis: 'dyert janë të hapura.' Ai trokiti në derë.

'Hej?' 'A ka njeri këtu?' Ideja për t'u futur brenda nuk iu pëlqeu, ndaj duke ecur anash shtëpisë dolën në pjesën e pasme të saj. Aty u ndeshën me një plevicë. Një garazh që përbëhej prej dypjesësh. Një hambar, apo një stallë në largësi diku në mes të fushës. Pa shenja jete.

'Ndoshta kjo nuk është shtëpia që kërkojmë,' tha Francis. 'Hej!'

Befas, bashkëshortët Phillips u shfaqën në largësi anës plevicës; të dy qëndronin në këmbë pa lëvizur. Më pas, si të ishte rishtypur një buton që i kishte ngrirë më parë, ata nisën të bëjnë përpara duke shkelur mbi bar. Kishin një pamje më të rëndë se ajo që kishin pasur në hotel.

Gjithsesi, kjo përshtypje kaloi shumë shpejt. Pat-i dhe Francis u mirëpritën përzemërsisht, dhe më pas, burrat u larguan në drejtim të makinës për ta marrë bagazhin. Evelyn-a shoqëroi Pat-in derisa ato u futën brenda në shtëpi, dhe bashkë me to hyri aty dhe blertësia e ditës verore. Aty kishte libra kudo, një oxhak të hapur, fotografi fëmijësh shembullorë të ulur përballë një pianoje të madhe, dhe mbi kokë, në tavanin e kuzhinës me tulla të verdha e të kuqe, një ventilator i vjetër, por mjaft i bukur.

'Më duket sikur kam një jetë të tërë që e njoh këtë shtëpi,' tha Pat-i. 'Ngjason shumë me shtëpinë time të vjetër.'

'Të dy çiftet ngjajmë shumë me njëri-tjetrin' tha Evelyn-a. 'A e keni vënë re se të gjithë kemi emra androgjinë?'

Pat-i ktheu kokën nga ana tjetër, dhe tha se shpresonte që Evelyn-ës as që do t'i shkonte në mend se ajo vetë dhe Francis ishin androgjinë.

Evelyn-a qeshi buzë më buzë dhe tha se ajo që kishte dashur të thoshte ishte se emrat e tyre *nuk kishin gjini*. Sa mirë që është të mos kesh gjini sot.'

'Me çfarë jeni marrë në rininë tuaj, Pat?' pyeti ajo më vonë tek lante sallatën në kuzhinë.

'Atëherë, ma ha mendja, me asgjë. Pasi mbarova studimet në Oxford.'

Evelyn-a, e habitur, u përlot, 'Edhe unë s'kam bërë asgjë. Me të mbaruar studimet në Cambridge, u martova. Mendoja se njerëz të kategorisë sonë nuk ekzistonin më.'

Dreka ishte e përkryer. Mish rose, bizele, dhe crème brulée.

' I fshitë të gjitha brenda orës?' pyeti Francis.

Jocelyn-i solli shishen e dytë me një verë të mrekullueshme.

Në dhomën e gjumit mbizotëronin katër afishe dhe një basmë shumëngjyrëshe. Kishte gjithashtu lule dhe borsa me ujë të nxehtë.

'Këtu është *parajsë*!' tha Pat-i. Ajo ishte gati ta puthte në faqe Evelyn-ën, dhe madje dhe vetë Jocelyn-in. Sidoqoftë, hoqi dorë nga ideja.

Francis, i përskuqur nga efekti i rosës dhe verës së kuqe, tha, 'Po, parajsë.' Ai pushoi për një çast. 'Hoteli ishte i mirë,' tha ai, 'por, aty nuk flinim qetë. Ishte prania e detit.'

'Do të flemë sonte,' tha Pat-i. 'Tejet.'

Ata ranë në gjumë. Fjetën deri në orën dhjetë të mëngjesit të ditës së nesërme, dhe s'po i besonin syve.

U zgjuan në një qetësi absolute.

'O Zot,' thirri Francis, 'na duhet të nisemi menjëherë nëse nuk duam të na kapi trafiku i dendur. Është më mirë të mos bëjmë dush.'

'A ka njeri këtu?' thirri Pat-i nëpër shkallë. Më pas në sallon. 'Na vjen shumë turp nga vetja. A ka njeri këtu?'

Qetësi e plotë. Ata kontrolluan në kuzhinë, dhomën e ngrënies, dhomën e ndenjjes, në studio. Asnjë shenjë nga dreka e një dite më parë, apo nga mëngjesi i sotëm. Dera kryesore dhe e pasme e shtëpisë ishin të hapura.

'Mos duhet të hedhim një sy në dhomat e gjumit?'

Edhe aty nuk ishte askush.

Në dhomën e gjumit të bashkëshortëve Phillips gjithçka ishte në rregull. Tesha mbi karrige nuk kishte, as plaçka të nxjerra nga çantat e udhëtimit, dhe as një fije floku në ndonjë krehër. Shtretërit ishin rregulluar me kujdes.

Phipps-ët dolën jashtë. Plevica, garazhi dhe stalla ishin aty, por këmbë njeriu nuk kishte. Pat-i tregoi me dorë. 'Ishte ai aty mbrëmë?' Në mes të kopshtit, një shtrat prej pëlhure, në ngjyrë rozë, qëndronte i varur në ajër ndërmjet dy pemëve.

'Hëm, shiko këtu,' tha Francis, 'duhet të largohemi. Kjo është për të qeshur. Do të lë një shënim. Është tepër shqetësuese.'

Ai shënoi diçka dhe e mbështeti pusullën te telefoni i kuzhinës, ku drita e vogël e mesazheve ndizej dhe shuhej vazhdimisht.

'Mos është më mirë ta shtyp butonin e mesazheve të telefonit?' pyeti ai.

'Jo,' tha ajo. 'Jo, nuk është e nevojshme,' dhe e tërhoqi nga krahu.

'Përse jo?'

'Jo!'

Ata mbyllën derën e pasme dhe derën kryesore. Ishte një lloj gjesti. Duhej bërë. Makina lëvizi në rruginën e zhavorrit përpara shtëpisë.

'Kjo që po bëjmë nuk më pëlqen,' tha ai. 'Nuk më pëlqen aspak. Duhej ta kisha shtypur atë buton. 'Sidoqoftë...do t'i marrim në telefon sonte në mbrëmje. Natyrisht – '

'Unë nuk jam e sigurt,' tha ajo. 'Nuk jam e sigurt se kam dëshirë për ta bërë një gjë të tillë. Nuk jam e sigurt se do të jemi në gjendje për ta bërë një gjë të tillë. Oh, Francis, nuk jam e sigurt nëse do të mbërrijmë në shtëpi.'

Tek ngiste makinën ai e kapi atë nga dora. Duke drejtuar mjetin me njërën dorë në rrugën e ngushtë anash gardhit me tela, si ai ashtu edhe ajo i hodhën një sy shtëpisë pranë së cilës po kalonin.

Dera kryesore dhe dera e pasme ishin sërish krejtësisht të hapura. Ata ishin në gjendje, me shumë qartësi, t'i shikonin fushat e gjelbra që shtriheshin përtej.

Romancierja Jane Gordam (Jean Mary Pearson) u lind në Coatham, North Yorkshire, më 11 korrik 1928. Ka studiuar letërsi angleze në Bedford College. Pasi u diplomua në vitin 1949, ajo punoi si bibliotekare shëtitëse e Kryqit të Kuq për bibliotekat e spitaleve, kurse më vonë u muar me gazetari.

Libri i parë i saj është romani për fëmijë "Një rrugë e gjatë prej Verone" ((një histori e rrëfyer në vetën e parë nga një 13 vjeçare) u botua në vitin 1971. Pavarësisht nga fillimi i vonë (shkrimtarja ishte mbi dyzet vjeçe, kur doli ky libër), Gardam u bë një nga romancierët më prodhimtarë të brezit të saj: për 30 vjet ajo botoi 25 libra, shumica e të cilëve janë nderuar me çmime prestigjioze

EDGAR POE • EMILY DICKINSON • HENRY LONGFELLOW • WALT WHITMAN • ROBERT FROST • SYLVIA PLATH • T. S. ELIOT

PSALME PËR JETËN

Shqipëroi nga origjinali dhe përgatiti:
Artur Balli

EDGAR ALLAN POE

Ëndërr brenda ëndrrës

Këtë puthje përmbi ballë prano nga mua!
Dhe tani që po ik larg syve të tua
Vetëm lërmë të të them dy fjalë që dua –
S'e ke keq, aspak, për mua, në ke thënë
Se veç ëndërr, ah, të miat dit' kan' qënë;
Dhe pastaj, në qoftë shpresa fluturuar
Në një natë apo ditë është shuar
Apo brenda një vegimi është fikur,
A nuk është ajo, kështu, njësoj e ikur?
Gjithçka shohim edhe ngjajmë kësaj bote kaq të vjetër
Ëndërr është, brenda ëndrrës, asgjë tjetër.

Un' qëndroj buzë një bregu të vetmuar
Prej përplasjeve të dallgës torturuar.
Dhe në dorë mbaj, shtrënguar, grushtit tim
Grimca rëre ngjyrë ar e plot shkëlqim.
Sa pak mbetur! Dhe si shkasin lehtësisht
Përmes gishtash dhe në det bien sërish
Prandaj qaj edhe vajtoj me lot e trisht'.
O Zot! S'mundkam ato grimca t'i mbaj dot
Brenda dorës, në një grusht të mbyllur fort?
O Zot! S'mundkam, veç disa, t'i shtrëngoj mirë,
T'i shpëtoj ato nga val' e pamëshirë?
Mos çka shohim edhe ngjajmë kësaj bote kaq të vjetër
Ëndërr është, brenda ëndrrës, asgjë tjetër?

* * *

Shënim: *Ëndërr brenda ëndrrës,* e botuar së pari më 1849, është e famshme për mënyrën se si paraqet krizën ekzistenciale të jetës së përkohshme. Nëpërmjet dy strofave aq të ndryshme nga njëra-tjetra poeti do të tregojë ndryshimin mes ëndrrës dhe realitetit (ose realitetit të brendshëm dhe atij të jashtëm).

Poezia përcjell gjendjen e ngarkuar mendore prej ankthit e konfuzionit të thellë të poetit tek sheh se gjërat e rëndësishme në jetë shkasin tutje pa kuptuar.

EMILY DICKINSON

Një Zog u ul ndanë udhës sime

Një Zog u ul ndanë udhës sime –
Dhe nuk më pa q'isha përballë –
Me sqep e ndau një Krimb Toke, mespërmes
E hëngri mikun krimb, të gjallë,

Dhe Vesë piu përmbi Barin
Që kishte mbirë udhës, pranë –
Pastaj, t'i hapte rrug' një Brumbulli, të shkonte,
Drejt Murit, hop, u hodh mënjanë –

Dhe syt' si zare aq të bukur
I hidhte rrotull, frikësuar –
Dhe Kokën Pendkadife, tek e shihja
E kthente, gjith' kujdes, nxituar

Sikur të priste një Rrezik –
Ia zgjata dorën me Thërrime,
Por shpleksi ai pendët. Krahët, butësisht
E shtynë qiellit të tij –

Siç Rremat çajnë Oqeanin
Dhe lënë pas tegel t'argjendtë –
Apo si Fluturat, prej Ledhit të Mesditës
Që pa spërkatje kridhen në lundrim.

* * *

Shënime: Kjo poezi, e thjeshtë në dukje dhe larg natyrës mistike të një pjese të madhe të krijimtarisë së poetes, do të ishte perfekte për lexuesit e rinj të poezisë. Ajo vlerësohet për muzikalitetin, ritmin e përsosur dhe imazhet e gjalla, duke treguar se ngjarje të thjeshta, të zakonshme, të jetës së përditshme mund të shpjegojnë bukurinë e natyrës. Zogu bëhet një emblemë esenciale, e gjallë, e egër, e pakapshme, që distancon natyrën nga njerëzit, të cilët dëshirojnë ta zotërojnë apo ta zbutin atë.

HENRY WADSWORTH LONGFELLOW

Batica ngrihet, batica zbret

Batica ngrihet, batica zbret,
Muzgu rrëzohet, çafka thërret;
Përmbi rërën qull, kafe – përgjatë detit
Udhëtari nxiton hapin drejt qytetit,
Dhe batica ngrihet, batica zbret.

Terri mbulon çati e mure në qytet,
Dhe deti çirret errësirës e thërret;
Dallgët e vogla, shkumëbardha, fshijn' me duar
Gjurmët e hapave mbi rërë, papushuar
Dhe batica ngrihet, batica zbret.

Mëngjesi feks; kali aty, në stallë të vet
Këmbët përplas e hingëllin, stallieri thërret;
Dita kthehet përsëri e zbardh çdo shteg,
Por s'kthehet kurr', më, udhëtari n'atë breg.
Dhe batica ngrihet, batica zbret.

* * *

Shënime: *Batica ngrihet, batica zbret* është një poezi mjaft e njohur që dallon për thjeshtësinë, bukurinë artistike dhe veçantinë e strukturës së vargut. Lëvizja ciklike dhe pa mbarim të baticës, që tregon ekzistencën e pafundme të universit, vjen në kontrast me ciklin "e shkurtër" të jetës njerëzore; udhëtari nuk kthehet më në breg se ka vdekur. Natyra që vazhdon ekzistencën e saj mes procesesh ciklike është indiferente ndaj humbjes së jetëve njerëzore, bile koha, e pandjeshme, fshin pareshtur gjurmët e atyre që nuk janë më.

WALT WHITMAN

Rri e vështroj

Rri e vështroj mbi gjithë dhimbjet e kësaj bote
dhe mbi gjithë mizoritë, paturpësitë;
Dëgjoj gulçet drithëruese të të rinjve, agonitë që fshehur
mbajnë brenda, me pendimin për ç'kanë bërë;
Shikoj nëna nëpër geto, duke vdekur, abuzuar
prej fëmijëve, shpërfillur, zemërthyer, dëshpëruar;
Shikoj gra keq të dhunuara nga burrat – shoh mashtrues
të pabesë vajzash të vogla;
Vrej përvëlimin e xhelozisë dhe dashuritë e pafat
që bëjnë çmos t'i fshihen botës,
gjithë këto pamje i kam në sy
Shoh pasojat e betejave, murtajat, tiranitë – shoh martirë
dhe burgaxhinj
Para syve kam urinë në mes të detit – marinarët duke zgjedhur
ata që duhen vrarë, të tjerët që të mund të mbijetojnë.
Vëzhgoj injorimin, poshtërimin e arrogantëve
ndaj punëtorëve, varfanjakëve dhe zezakëve,
a të ngjashmëve me ta
Që të gjitha – të gjitha poshtërsitë edhe agonitë
që s'kanë fund, rri dhe i vështroj
Shikoj, dëgjoj dhe hesht.

* * *

Shënime: Toni i kësaj poezie është fund e krye negativ dhe pesimist, ndërsa imazheria apokaliptike. Ardhja e sistemit kapitalist, tmerrësisht të egër, në fillimet e tij, përveçse burim mjerimi e varfërie për masat e gjera, ishte edhe një impakt i frikshëm mbi jetët e njerëzve, ku parimet sociale shkeleshin hapur prej interesave individuale e të ngushta. Bota ishte e mbushur me kaq mizori, mëkate dhe errësirë, sa poeti nuk mund t'i hiqte nga sytë për asnjë çast.

Por ai vetëm shikon, vështron, dëgjon, vëzhgon, vëren dhe nuk mund të bëjë asgjë tjetër. Duhet të ketë qenë e rëndë për të, të shohë dhe të mos mundë të ndihmojë njerëzit. Mbase kjo ka qenë arsyeja që ai shkroi *Rri dhe vështroj*.

ROBERT FROST

Jam njohur me natën

Kam qenë dikush që natën ka njohur e kuptuar.
Kam dalë në shi e jam kthyer mes shiut rrebesh
Jam endur tej kufijve të qytetit, dritashuar.

Kam parë shtegun më të trishtë të qytetit që nuk qesh
Jam gjendur fare pranë një polici, krejt papritur,
Kam ulur sytë përdhe, që sytë e tij mos ndesh.

Kam ndaluar një çast zhurmat e hapit të zvarritur
Të ndërprera nga një klithmë që prej tej çative vinte
Prej një tjetër rruge, ajo klithmë, në qiell ngjitur

Por që s'ish për mua e për mua s'desh të dinte.
Dhe, më larg, në përmasa të çuditshme, lartësuar
Një sahat i ndritshëm, në qiell varur, ndehej e rrinte

Dhe s'ish e saktë koha që tregonte, as ish e gabuar.
Kam qenë dikush që natën ka njohur e kuptuar.

Shënime: "Poezia ta bën të mundur të thuash diçka dhe të nënkuptosh diçka tjetër", - thoshte Frost-i dhe *Jam njohur me natën* është, ndoshta, ndër shembujt më ekstremë të kësaj mënyre tipike të të shprehurit të tij në vargje.

SYLVIA PLATH

Këngë dashurie e një vajze të çmendur

"Mbyll sytë dhe gjithë bota bie e vdes, në errësirë;
Dhe pastaj, kur ngre qepallat, gjithçka rilindet përsëri.
(Ndoshta s'je tjetër, veç fantazi, në kokën time mbirë.)

Yjet blu-kuq, duke vallëzuar, largohen n'hapësirë,
Ndërsa brenda, galopuar, vërshon dhunshëm terri i zi:
Mbyll sytë dhe gjithë bota bie e vdes, në errësirë.

Ti, në ëndërr, më magjepsje, të më merrje në shtrat, shtrirë
Dhe si më puthje e më këndoje ishte krejt një çmenduri.
(Ndoshta s'je tjetër, veç fantazi, në kokën time mbirë.)

Rrëzohet nga qielli Zoti, heshtet ferri zjarrpërpirë:
Largohen prej skenës engjëjt, Satani me bandën e tij:
Mbyll sytë dhe gjithë bota bie e vdes, në errësirë.

Siç më premtove, prita të kthehesh, plot zjarr e dëshirë,
Por, ndërsa plakem, edhe emrin tënd harruar kam, tani.
(Ndoshta s'je tjetër, veç fantazi, në kokën time mbirë.)

Të isha dashuruar me ndonjë zog mitik, më mirë:
Se të paktën, klithje e tyre, çdo pranverë vjen përsëri.
Mbyll sytë dhe gjithë bota bie e vdes, në errësirë.
(Ndoshta s'je tjetër, veç fantazi, në kokën time mbirë.)"

* * *

Shënime: E shkruar në formën e një vilanele, *Këngë dashurie e një vajze të çmendur* është një poezi tepër e veçantë mes poezive më të njohura të Sylvia Plath-it. Edhe pse tenton të duket sikur të ishte vërtet një këngë (shih thonjëzat në krye dhe në fund të poezisë), nuk është vështirë të dallosh vetë Plath-in pas figurës së personazhit të poezisë.

Një grua e re, pasi ka humbur dashurinë që e kishte të shtrenjtë sa jeta, lufton me gjendjen e saj mendore, të cenuar rëndë prej depresionit. Për të përballuar dhimbjen ajo alternon qëndrimin e saj në mënyrë të përsëritur, nga izolimi te mohimi dhe anasjelltas: ajo mbyll sytë për të shpëtuar veten brenda mendjes së saj dhe pastaj, kur hap sytë dhe i duhet të përballet me realitetin, përpiqet të mohojë ekzistencën e të dashurit të saj. Por, si izolimi ashtu edhe mohimi nuk bëjnë tjetër veçse rëndojnë më tepër vetminë dhe dëshpërimin e saj.

Nëpërmjet një imazherie pikante poetja përdor figura e simbole religjioze, përfshirë Zotin, engjëjt, Satanain me gjithë demonë, duke e imagjinuar veten të kapur në grackën e një pasjete më të vetmuar se vetë ferri; me parajsën e ferrin të boshatisur, ajo ka mbetur brenda errësirës së dhunshme të mendjes së saj.

THOMAS STEARNS ELIOT

Emri i maceve

Maceve, që t'u vësh emrin, ësht' një punë e koklavitur
Nuk ngjan aspak si lojë fundjave me të cilën kohën ze;
Për një çast, sa kapel'bërësi mund t'ju dukem i lajthitur[1]
Po t'ju them se për një mace, s'duhet një emër, duhen tre.

Për së pari lipset një emër i zakonshëm, familjar
Si për shembull Piter, August, apo Alonso e Viktor,
A për shembull Xhonatan, Xhejms, Bill Beili apo Oskar –[2]
Të gjithë emra të arsyeshëm për një përdorim ditor.

Ka edhe emra me më tepër harmoni e karakter,
Emra që me nder i mban një damë apo një zotëri:
Si për shembull, Plato, Admetus, Elektra a Oliver –
Që të gjithë këta emra, familjarë, plot ndjeshmëri.

Por ju them se macja do edhe një emër, të veçantë, krejt,
Të jetë tipik e dinjitoz dhe me më tepër tingëllimë
Si mund, përndryshe, që ta mbajë ajo bishtin, ngritur, drejt?
Si mund mustaqet që t'i shtrijë krenarisht edhe me sqimë?

Dhe për emra të këtij lloji, mund t'ju jap unë një kuorum,
Si për shembull, Mankustrap ose Kuakso, Korikopetë,
Apo për shembull Bombalurina, bile dhe Xhelilorum –
Emra që vetëm njëra mace në gjith' botën, mund t'i ketë.

Por nuk mbaron puna këtu sepse mungon një emër tjetër;
Një emër që askurrë ndokush nga ju nuk mund ta gjejë;
As e zbulon, dot, një kërkim shkencor i ri apo i vjetër –
Macja, vetë, atë e di, dhe pse askujt s'do t'ia rrëfejë.

Dhe kur një mace ta shikoni, tek përhumbet medituar
Të më besoni, se nuk ka asnjë arsye veç kësaj:
Mendja e maces thellësirash fantazie është harruar
Nga mendimi i mendimit të mendimit të emrit të saj:

Të pashqiptim shqiptueshmin,
Të shqiptimpashqiptueshmin,
Atë, unikun, thellësisht enigmatikun emër të saj.

* * *

Shënime: *Emri i maceve* është një poezi tepër e veçantë dhe e njohur e Eliotit që vjen në formën e një dialogu ritmik e të rimuar i cili përshkruan, me një frymë humori të mprehtë, se si macet i marrin apo i zgjedhin emrat e tyre. Poezia personifikon macet, duke u dhënë atyre një nivel human interioriteti e psikike dhe duke argumentuar se macet, ashtu si njerëzit, shprehin në një mënyrë të trefishtë identitetin dhe botën e tyre të brendshme: së pari, është "vetja" sociale (mënyra si ato prezantohen në publik), së dyti, "vetja" intime (mënyra se si ato ofrohen te miqtë dhe të afërmit) dhe së treti, "vetja" private (ajo që njihet thellësisht vetëm nga vetë individi dhe që tregon se natyra unike e botës së brendshme të gjithkujt, pra identiteti dhe interioriteti i individit njihet nga vetë ai si askush tjetër). Dhe për çdo situatë poeti ofron emra specifikë që janë realisht emra të përdorur për macet.

1 Krahasimi i referohet kapelabërësit te *Liza në botën e çudirave*.
2 Bill Beili, referuar një kënge të vitit 1902, *Won't You Come Home Bill Bailey*.

Përsiatje rreth përkthimit të poemës "Aksion esti" në shqip

ELITIS NË SHQIP DHE DISA PROBLEME TË PËRKTHIMIT TË POEZISË SË TIJ

nga Aristotel Spiro

Në fjalën e mbajtur para Akademisë së Stokholmit me rastin e akordimit të Çmimit Nobel, Odiseas Elitis do t'u drejtohej të pranishmëve shprehimisht: "Ju njohim dhe na njihni përmes 20% a mbase 30% që mbetet pas përkthimit". Nëpërmjet kësaj shprehjeje në formë aforizmi poeti i shquar konfirmonte bindjen për artin e tij të madh, i cili arrinte të emocononte qoftë edhe pas deficitit që krijonte akti përkthimor. Në kohën që fitoi Nobelin, Elitis ishte i panjohur në Shqipëri. Në këtë kontekst, citimi i mësipërm tingëllon sidomos profetik për botimin shqip të poezisë së tij.

Ka shumë faktorë që e bëjnë përkthimin e poezisë elitiane të vështirë. E para buron nga vetë lloji letrar, që mbështetet në sistemin shenjor estetik të çdo gjuhe, një sistem i përpunuar gradualisht me kontributin e brezave të tërë letrarë. Këto sisteme shenjore imponojnë marrëdhënie të caktuara ndërtekstore, që ndryshojnë nga njëra letërsi në tjetrën. Një vepër e përkthyer keq ndikohet nga ky ndërtekstualitet dhe rrezikon dekodifikimin e saj, ndërsa një vepër e përkthyer mirë elementet e saj shenjore tenton t'i trupëzojë brenda sistemit estetik të letërsisë mikpritëse. Titulli i veprës "Aksion esti", ashtu i pandryshuar, i papërkthyer, është bërë pjesë e ligjërimit poetik botëror, pra edhe e atij shqip. Si një nga shprehjet më të njohura të traditës së krishterë, ajo nuk mund të gjejë një barasvlerës shenjor në asnjë gjuhë të qytetërimit perëndimor, përveçse me veten e vet. Një gjë e tillë ndodh rëndom me terminologjinë fetare, e cila funksionon në tekst si njësi përkthimore e veçantë. Por në tekstin shqip të "Aksion esti"-së, i cili mbështetet mbi figuracionin biblik, ky rregull nuk zbatohet gjithmonë. Kështu, p.sh. me pasoja për deshifrimin kuptimor dhe estetik është përkthimi i leximit të tretë të *Aksion esti*-së si "*Dalja e madhe*" (91), që duhej përkthyer në fakt "*Eksodi i madh*", meqenëse figura letrare mbështetet mbi ngjarjet që përshkruhen në Librin II të Pentateuchon-it (Eksodi), largimin e izraelitëve nga Egjipti drejt "Tokës së Premtuar". Por kjo metonimi ka pasur në Greqi edhe një përdorim historik, dhe pikërisht në kohën e Revolucionit të 1821-shit, kur kryengritësit e rrethuar të Mesolongjit çanë rrethimin e forcave turke dhe dolën nga qyteti (1826). Njohja e regjistrit stilistikor kishtar si njësi përkthimore më vete e bën të detyrueshme përzgjedhjen e terminologjisë fetare në rastet kur ajo shfaqet. Duke përdorur si shkas Shkrimin e Shenjtë, Elitis ka krijuar një sistem figuracioni letrar, ku fjalë me përdorim të zakonshëm ose neologjizma ndërthuren me terminologjinë ekzistuese të krishterë, duke u bërë bartëse të një simbolizmi metonimik: apelativi ose fjala e zakonshme fiton kuptimin e një nocioni themelor, shprehës vlerash të larta. Këtu hyjnë në punë edhe mjetet drejtshkrimore, përdorimi i shkronjës kapitale, zbukurimet e teksteve kodike etj. Këto detaje i ka pasur parasysh përkthyesi dhe me intuitën e vet letrare ka ecur drejt rindërtimit të këtij sistemi simbolesh duke shfrytëzuar lëndën gjuhësore shqipe. Shembuj të tillë mund të lokalizohen lehtë. *Μακρινή Μητέρα - Ρόδο μου Αμάραντο* (122) *Mëma ime e Largët - Trëndafil i Pavdekshëm* (123), *Ο Τοκετός - η Θέωσις το Αεί* (128) *Lindja - Hyjnizimi, e Përjetshmja* (129), *Χαίρε η Καιομένη και χαίρε η Χλωρή / Χαίρε η Αμεταμέλητη με το πρωραίο σπαθί* (150*) Përshëndetje e Vëluara dhe përshëndetje Njomzakja / Përshëndetje e Papenduara me të bashit shpatë* (151). *Χαίρε η Ονειροτόκος χαίρε η Πελαγινή / Χαίρε η Αγκυροφόρος και η Πενταστέρινη* (152) Përshëndetje Ëndërrpjellëses përshëndetje Detares / Përshëndetje Spirancëmbajtëses dhe Supëryllores (153) *Χαίρε που καταρτίζεις τα Μηναία των Κήπων / Χαίρε που αρμόζεις τη ζώνη του Οφιούχου* (152) Përshëndetje që përpilon festat Mujore të Kopshteve / Përshëndetje që harmonizon brezin e Gjarpërushës (153).

Një vështirësi tjetër përbën edhe konteksti historik dhe gjeografik, që në gjuhën mbërritëse merr zakonisht një vlerë thjesht denotative, ndërsa në gjuhën zanafillëse mbushet me konotacione gjuhësore, letrare dhe kulturore, për shkak të rëndësisë në jetën e lexuesve. Emrat gjeografikë të Greqisë janë elemente të një semiologjie kulturore, që nuk mund të përçohen në *translatum* në mënyrë të pandryshuar. Dhe kjo ndodh sepse kuptimi dhe bashkëshënjimi (konotacioni) është një ndryshore në funksion jo vetëm të kontekstit gjuhësor por edhe të atij kulturor dhe sidomos të këtij të fundit. Sigurisht, përkthimi mund të karakterizohet cilësisht i saktë, por emocioni i përcjellë është asimetrik. P.sh.: *"η Ίος, η Σίκινος, η Σέριφος, η Μήλος"* (34), përkthehen siç është e kuptueshme "*Ios, Siqinos, Serifos, Milos*" (35). Ajo që i mungon këtu lexuesit shqiptar është konteksti kulturor, gjeografik, historik, i cili do të mund të plotësohej mjaftueshëm

përmes shënimeve në fund të faqes apo librit. Këto shënime mungojnë, siç mungojnë edhe plot shpjegime të tjera të pritshme, siç do të ishte përkthimi i vargut të njohur të Hölderlinit nga gjermanishtja *Wozu Dichter in dürftiger Zeit*, apo grafitë frëngjisht për Rembonë (*Rimbaud*) dhe Matisin (*Matisse*), që lexohen gabimisht si të ishin fjalë shqipe, dhe dalin në fjalëforma të çuditshme (Rimbaudi, Matissesë, 20).

Vështirësia e tretë lidhet me ballafaqimet e sistemeve gjuhësore përmes mundësive të ndryshme fjalëformuese e inventarit të pabarabartë semiologjik, fonetik e gramatikor. Por ajo që duket si një problem gjuhësor është në fakt një mospërkatësi në zbërthimin e përvojës së shprehur gjuhësisht.

Përkthyesi i sprovuar i shfrytëzon mjetet e gjuhës mikpritëse për të kompensuar mjetet e saj munguese semantike dhe gramatikore, si dhe për t'i siguruar çdo fjale mjedisin e saj të natyrshëm paradigmatik e sintagmatik. Përballimi i çdo njësie përkthimore është një histori e veçantë në komunikimin ndërkulturor dhe çdo sukses i saj përbën një ngjarje të vogël në dialogun e kulturave. Fjalëformimi me anën e kompozimit si dhe prania e disa mënyrave foljore si habitorja, dëshirorja apo edhe kushtorja, elipsa e vetëmjaftueshme në greqishte dhe e pavetëmjaftueshme në shqipe janë disa nga sfidat me të cilat ndeshet përkthyesi.

Në përkthimin shqip të poezisë së Elitisit gjejmë p.sh. përdorimin me vend të habitores a dëshirores, atje ku mospërdorimi i saj do të ngjante i çuditshëm: *Dhe gjuhë asnjë nuk paska* (95); *kjo botë kjo* - e njëjta botë qenka (99). *Fshatarë të një lloji tjetër ne, me lloje të tjera kazmash dhe hekurash në duar, që të përbetuara* (sic) *qofshin* (61).

Puna me poezinë elitiane kërkon megjithatë identifikimin, vlerësimin dhe përpunimin e çdo njësie përkthimore: çdo fjalë, çdo varg, çdo kuptim është një ecejake gjuhësore, kulturore, një pohim, konfirmim e rikonfirmim përdorimesh e vlerash të krijuara rishtas. Përndryshe, zgjedhjet e pamenduara e të nxituara tërheqin padrejtësisht vëmendjen e lexuesit në dëm të fokusimit në tërësinë e mesazhit estetik. Gracka të tilla përkthyesi gjen plot në rrugën e vet. Një sosh është f.v. humnera ndërtimore e elipsës së natyrshme greke, aq e panatyrshme në shqip, e cila për këtë arsye duhet mbushur patjetër. Në të vërtetë kjo është grackë vetëm e përkthyesit, sepse lexuesi me kompetencën gjuhësore që e karakterizon e pranon një ndërtim të mirëformuar gramatikisht dhe e refuzon një ndërtim të keqformuar duke mos vazhduar më tej. Të tilla identifikohen lehtësisht në përkthimin e Elitisit:

Στην αρχή το φως (28) *Në fillim drita* (29). *Εκεί ρόδια, κυδώνια / θεοί μελαχρινοί...* (56) *Atje shegë, ftonj / hyjni zeshkane...*(57). *Επειδή πολλοί φορούν το μελανό πουκάμισο* (48) *Meqë shumë kanë veshur këmishën e zezë* (49). *Ήρθαν / ντυμένοι "φίλοι"* (84) *Erdhën / të veshur* "miq" (85) khs. përkthimin anglisht *They came dressed up as "friends"* (përkth. nga E. Keeley, G. Savidis).

Fjalë në dukje të njëjta, si p.sh. *familje* dhe *φαμίλια* njohin përndarje të ndryshme sintaksore dhe stilistikore në gjuhët përkatëse. Emri *φαμίλια* në greqishte nuk ka atë kuptim që ka në shqipe. Përdoret, ndër të tjera, me kuptimin e fjalës *gjini* në shqip. Por në një përkthim të "pafajshëm" barazia e shënjuesit (signifiant) do të shërbente si shfajësim i zgjedhjeve përkthimore: *Ύστερα και οι άνεμοι όλοι της φαμίλιας μου έφτασαν* (30) *Pastaj dhe gjithë erërat e familjes sime mbërritën* (31). Në këtë kategori përfshihen edhe fjalë të tjera si p.sh. *lejlek* dhe *λελέκι*, që në greqisht i takon një

ligjërimi të thjeshtë, tek i cili mbështetet tradicionalisht gjuha poetike në greqisht. Në gr. përbën një zgjedhje midis dy fjalësh sinonime (dhe *λελέκι* dhe *πελαργός*), ndër të cilat fjala e parë është më popullore, ndërsa e dyta i takon ligjërimit të kujdesur.

Në përpjekjen për të trupëzuar elementet kulturore të origjinalit, përkthyesi është i detyruar të mbushë mozaikun shenjor përmes krijimit të fjalëve të reja, të cilat sillen brenda tekstit letrar si elemente të stilit të autorit. Në tekstin e përkthyer ato janë në të vërtetë përzgjedhje të përkthyesit, por duhet të japin përshtypjen e zgjedhjeve të autorit origjinal. Në këtë mënyrë ato mund të interpretohen dyfish: si *kryetekst* (duke kuptuar origjinalin) dhe si *variant tekstor* (duke kuptuar përkthimin), i cili ndodhet brenda një kuadri semiotik të paracaktuar. Në varësi të kompetencës përkthimore kjo marrëdhënie e përkthyesit mund të jetë marrëdhënie dashurie ose tiranie. Dëshmitë për karakterizimin e saj gjenden në përzgjedhjen e mjeteve përkthyese. Një rast domethënës është ai i neologjizmave kontekstuale, të cilat gjenden me shumicë në veprën e Odiseas Elitisit. Për shkak të një shfajësimi formal apo të një nevoje për të shkaktuar reagimin gjegjës në shqip, përkthyesi ka guxuar të krijojë fjalë të reja sipas gjedhes greke, mbështetur edhe në aftësitë fjalëformuese të sistemit gjuhësor shqip (fjalë të prejardhura dhe sidomos të përbëra). P.sh. *ερεβοκτόνο ρόδι* (36) *shegë terrvrasëse* (37), *εκατόγχειρες νύχτες* (88) *net qindraduarshe* (89). Por varësia e skajshme ndaj origjinalit ka dhënë shpeshherë përfundime fjalëformuese që duken si sajime të dhunshme, p.sh., *ηλιοπότης, ακριδοκτόνος* (54) *diellpirës, karkalecvrasës* (55), *metamorfozohem* (10).

Një kategori tjetër përbën përdorimi i ca fjalëve greke, të cilat sillen si huazime të një lloji të veçantë: ngjajnë si ndërkombëtarizma, por nuk janë gjithmonë të tilla. Janë të njëjtat tema leksikore të origjinalit, të cilave iu prapangjiten mbaresat rasore shqipe dhe funksionojnë brenda tekstit si huazime. Disa herë elementet e tyre përbërëse krijojnë lidhje homonimie me tema fjalëformuese të njohura edhe për ndërkombëtarizmat, por gjithsesi brenda një kuadri shpjegues etimologjik vulgar. Khs. *fiziolatri* (... që sjell adhurimin e natyrës, fiziolatri, 11), *paralogjik* (Ky dimension, paralogjik në dukje, korrespondon dhe me entitetin material e shpirtëror të vendit tim, 18), *homofag* (dhe janë Homofagët dhe të Egrit e Ujit, 49), *sitofobët* (Sitofobët dhe Pelidnët dhe Neokondorët, 49). Kur përdoren në funksion të një qëllimi organizues estetik të tekstit, përdorimi i tyre është i përligjur. Përkundrazi, përdorimi i tyre në emër të një zgjidhjeje sinoptike të imponuar nga dëshira për mbarimin e menjëhershëm të përkthimit konsiderohet i gabuar. Këto fjalë që përzgjidhen në mënyrë të papërligjur për shkak të parapëlqimeve që lidhen me shënjuesit origjinalë mund të quhen *pseudohuazime*, për t'iu kundërvënë atyre huazimeve që rrjedhin nga nevoja e rindërtimit të tekstit dhe përligjen nga funksionaliteti që i karakterizon.

Vështirësia e fundit lidhet me gabimet në përkthim, d.m.th. në përzgjedhjen e një fjale, ku si shënjuesi ashtu dhe i shënjuari nuk kanë lidhje më me origjinalin. Dhe të tilla në poezinë e përkthyer të O. Elitisit janë të shumta. Identifikohen dy kategori gabimesh: 1) leksikore dhe 2) gramatikore (morfologjike ose sintaksore). *Και το νέφος εχώρισαν στα δύο Και αυτό πάλι στα τέσσερα* (30) *Dhe renë ndanë në dysh Dhe kjo sërish në katër* (31). Do të pritej një përkthim i tillë: "*Dhe renë e ndanë më dysh Dhe atë sërish më katërsh*". *αλληλέγγυα στάθηκαν τα σπίτια / και μικρά και τετράγωνα* (36) *solidare u ngritën shtëpitë / dhe të vegjël dhe katrore* (37). *Εκεί ρόδια, κυδώνια / θεοί μελαχρινοί, θείοι κι εξάδελφοι* (56) *Atje shegë, ftonj / hyjni zeshkane, hyjnorë* (sic!) *dhe kushërinj* (57). Këtu *θείοι* nuk mund të përkthehet me mbiemër d.m.th. *hyjnorë*, meqenëse këtu funksionon si emër së bashku me gjymtyrën homogjene *εξάδελφοι*. Në këtë kontekst kuptimi i saj është "ungj/xhaxha/dajë", sepse si marrëdhëniet sintagmatike ashtu edhe ato paradigmatike sugjerojnë përkthimin me një fjalë që shënon farefisni.

Këto gabime, që burojnë nga moskompetenca gjuhësore, dhe, pra, nga kompetenca e pamjaftueshme përkthimore poetike, janë të lokalizueshme edhe tek përkthimi i fjalëve të veçanta ose i një radhe fjalësh: *νωχελικά* (32) *shkujdesur* (33). *Χαμηλά στων φύλλων τον πυθμένα / η τριβίδα η λεία* (38) *Poshtë pafundësisë së gjetheve / zalli i rrëmbyer* (39). Disa herë ngatërrohet përdorimi i paronimeve: *τη φορά του ανέμου εξαγοράζοντας* (68) *vrundullin e erës duke shpërblyer* (69). *και στα κρυφά μου αντικαταστήσανε / την παρθένα του βλέμματος* (68) *dhe fshehtësisht ma zëvendësuan / virgjërinë e vështrimit* (69). *τρικύμησα / όπως κάβος πάτησα βαθιά / που αέρα πήρανε οι σπηλιές* (42) *furtunshëm / si pallamar u shtriva thellë / ku shpellat erë patën marrë* (43).

Në rolin e njësisë përkthimore del edhe numërimi i pjesëve dhe nënpjesëve të poemës. Shohim këtu një mospërputhje e cila buron nga mosbashkëpërkimi i alfabeteve të të dy gjuhëve: *α΄:a, β΄:b, γ΄:c, δ΄:ç, ε΄:d, στ΄:dh, ζ΄:e, η΄:ë*. Në



funksion numërues është më e arsyeshme të përdoret alfabeti origjinar latin, pra: *α΄:a, β΄:b, γ΄:c, δ΄:d, ε΄:e, στ΄:f, ζ΄:g, η΄:h* etj., ku bashkëpërkimet midis dy sistemeve shkrimore janë më të qarta e më të sakta.

PËRFUNDIME:

"Aksion esti" karakterizohet nga prania e një semiologjie me informativitet të lartë për shkak të përdorimit të fjalëve me konotacion të veçantë, të fituar brenda idiolektit letrar të O. Elitisit. Autori ka vënë në lëvizje një mekanizëm, që gjeneron jo vetëm kuptime të reja, por edhe njësi të reja leksematike, të cilat mbeten gjithsesi kryesisht brenda krijimtarisë së vet, si elemente përbërëse dhe dalluese të nyjëtimit të tij letrar.

Vështirësitë në dekodifikimin e saj lidhen me këtë veçori. Ato shtohen më shumë gjatë përkthimit në një gjuhë tjetër, si p.sh. në shqip, ku çdo zgjedhje përkthimore vjen si rezultat i një vendimi të marrë në kushte të vështira.

Dhjetë vjet pas përkthimit dhe botimit të tij në libër të veçantë në gjuhën shqipe do të pritej që O. Elitis, pasi iu trupëzua letërsisë shqiptare dhe asaj botërore të shkruar në shqip, të kishte një impakt mbi letërsinë shqipe. Sot, pas dhjetë vjetësh mund të thuhet se poeti nobelist grek është për lexuesin shqiptar thuajse aq i panjohur sa më parë. Në prodhimin letrar shqip nuk ndeshet ndonjë gjurmë ndërtekstualiteti të lidhur me veprën e tij.

Fakti i botimit dygjuhësh, mjaft komod për specialistin që njeh si greqishten ashtu edhe shqipen, me sa duket nuk ka ndihmuar në këtë dekodifikim, pavarësisht domethënies së dyfishtë të botimit: nga njëra anë i jepet mundësia lexuesit që të këshillohet me krijimin burimor, tekstin zanafillës, dhe të jetë i ndërgjegjshëm për ndryshimet formale e kuptimore që ndodhin gjatë përkthimit, nga ana tjetër përkthyesi pretendon të ketë arritur rikompozimin e një teksti të kompletuar, që është i barasvlershëm me origjinalin.

Prapëseprapë, vendosja e origjinalit nuk arrin ta zhdukë hendekun kulturor që ndan lexuesin nga teksti shqip, përderisa teksti origjinal luan një rol shpjegues e verifikues vetëm për njohësin e të dyja gjuhëve. Rolin orientues mund ta luajnë nga njëra anë shpjegimet në fund të faqes ose një aparat shpjegues analitik, dhe nga ana tjetër një përkthim i kryer me frymëzim e kujdes, pas një njohjeje të thellë të veprës.

Shembulli i përkthimit të "*Aksion esti*"-së tregon se dekodifikimi i një vepre letrare nuk mbaron me përkthimin e saj, por me analizën e vazhdueshme si në origjinal ashtu edhe në përkthim, i cili mund të shihet si një version i shpjeguar i veprës. Shoqërimi i përkthimit me shpjegimet e domosdoshme në fund të faqes apo të librit do të ndihmonte për të kuptuar më mirë sistemin e figuracionit letrar estetik të Elitisit, si dhe kontekstin kulturor brenda të cilit është vendosur vepra e tij "*Aksion esti*". Por këto mungojnë krejtësisht tek botimi shqip i Elitisit[1].

Kështu shpjegohet pse poeti i shquar ende nuk është gjerësisht i njohur në Shqipëri. Edhe pse ka mbërritur në gjuhën shqipe dhe "ka veshur" petkat e saj, fillimisht përmes përfshirjes në "*Antologjinë e poezisë greke*" (1986) me disa përkthime kryesisht të I. Kadaresë, dhe vijimisht me botimin e një libri të veçantë në përkthimin e N. Kacalidhës, si dhe me botime poezish të shpërndara nëpër gazetat dhe periodikët letrarë, mbetet ende për t'u kryer komunikimi i tij real me pranuesit e këtij ligjërimi poetik: lexuesit shqiptarë[2].

Një rol të tillë luajnë artikujt dhe studimet për mjeshtërinë e artistike të poetit si dhe veprimtari të ndryshme kushtuar veprës së tij. Ato ndihmojnë për të kuptuar më mirë një autor të përmasave botërore si Odiseas Elitis.

1 Odiseas Elitis, *Poezi*. Shqipëroi nga origjinali Niko Kacalidha. Tiranë: Onufri, 2001.

2 Pas hartimit dhe kumtimit të këtij teksti doli në dritë një përmbledhje poezish e O. Elitisit në gjuhën shqipe (shih: Odiseas Elitis, *Poezi*, përkthyer nga Romeo Çollaku, Tiranë: Odeon, 2014), një botim shumë interesant, për të cilin parashikojmë se kritika letrare dhe përkthimore do të merren herë pas here.


ALBANIANS
in ART
Ferid HUDHRI